



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2020 – Numri: 88

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 18 maj 2020

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 13.5.2020	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të mjediseve të Arkivit Shtetëror Vendor të Qarkut Tiranë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar.....	4951
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.382, datë 13.5.2020	Për sigurimin e jetës së punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.....	4952
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 13.5.2020	Për miratimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare me karakter referues për sigurinë e lodrave, të vendosura në ambiente publike dhe private.....	4952
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 13.5.2020	Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale.....	4954
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 13.5.2020	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “Tokë bujqësore” në “Tokë urbane”, truall, të një sipërfaqeje të pasurisë me numër 242/2, zona kadastrale 1031, Bashkia Durrës.....	4958
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 13.5.2020	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “Tokë bujqësore” në “Tokë urbane”, truall, të një sipërfaqeje të pasurisë me numër 64/40, zona kadastrale 3743, Bashkia Patos.....	4961
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 13.5.2020	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “Tokë bujqësore” në “Tokë urbane”, truall, të një sipërfaqeje të pasurisë me numër 108/169, zona kadastrale 2420, Bashkia Pogradec.....	4965
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 13.5.2020	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “Tokë bujqësore” në “Tokë urbane”, truall, të një sipërfaqeje të pasurisë me numër 51/56, zona kadastrale 3428, Bashkia Shkodër.....	4968

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 394, datë 13.5.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksion i rrugës ‘Mihal Grameno’, si dhe degëzimit të rrugës ‘Budi’ me Depon e Ujit (faza e dytë)”, në Tiranë.....	4972
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 13.5.2020	Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.....	4974
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 13.5.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”.....	4975
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 13.5.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Loti 3”, Tiranë.....	4976
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 13.5.2020	Për përcaktimin e kufijve të Parkut Arkeologjik Durrës.....	4980
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 137, datë 27.4.2020	Për miratimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e përkohshëm.....	4985
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 136, datë 27.4.2020	Për miratimin e Kodit të Etikës Profesionale të Përmbaaruesit Gjyqësor Privat.....	4986
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 60, datë 8.4.2020	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin mars 2020.....	4990
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 61, datë 8.4.2020	Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	4991
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 62, datë 8.4.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “ERA Hydro” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Strori”, me kapacitet të instaluar 2000 kw.....	4993
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 63, datë 8.4.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Prevalli”, me kapacitet të instaluar 1750 kw.....	4995
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 64, datë 8.4.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	4997
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 66, datë 8.4.2020	Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 10.2.2020, “Mbi procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga furnizuesi i tregut të lirë, FTL sh.a.” .....	4998
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 22.4.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për zgjatje të afatit të përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës, për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.....	4999

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 22.4.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për zgjatje të afatit të përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencim, në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.....	5000
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 71, datë 22.4.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1”, me kapacitet të instaluar 5801 kw dhe “Veleshica 2”, me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total të instaluar 13917 kw.....	5002
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 22.4.2020	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., nr. 286, seria t15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015.....	5004
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 73, datë 22.4.2020	Mbi miratimin e kontratës tip, për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal, për furnizimin e klientëve fundorë.....	5006
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 74, datë 22.4.2020	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 kw.....	5016
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 75, datë 22.4.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “SPAHIU Gjanç” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për lënien peng të kuotave.....	5018
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 76, datë 22.4.2020	Mbi kërkesën e zyrtarit të pajtueshmërisë së OST sh.a., për shtyrjen e afatit të dorëzimit të “Raportit vjetor të pajtueshmërisë” të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.....	5019
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 77, datë 22.4.2020	Mbi kërkesën e zyrtarit të përputhshmërisë së “ALBGAZ” sh.a., për shtyrjen e afatit të dorëzimit të “Raportit vjetor të përputhshmërisë” të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror.....	5020



**VENDIM**  
**Nr. 381, datë 13.5.2020**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TEK AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS, TË MJEDISEVE TË ARKIVIT SHETËTOR VENDOR TË QARKUT TIRANË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, 13, 14 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 6 e 7, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, me

propozimin e Zëvendëkryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**


1. Ndryshimin e përgjegjësive së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të mjediseve të Arkivit Shtetëror Vendor të Qarkut Tiranë, të ndodhura në zonën kadastrale 8 330, me numër pasurie 8/114, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**





**VENDIM**  
**Nr. 382, datë 13.5.2020**

**PËR SIGURIMIN E JETËS SË  
PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT  
TË MBROJTJES NGA ZJARRI  
DHE SHPËTIMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32, të ligjit nr.152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë jetën e punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes Zjarri dhe Shpëtimin nga aksidentet gjatë kryerjes së shërbimit ose për shkak të tij.

2. Punonjësit, të cilët përfitojnë sigurim jete, janë vetëm punonjësit që kryejnë funksione operacionale.

3. Sigurimi i jetës nga aksidentet gjatë shërbimit ose për shkak të tij realizohet nëpërmjet lidhjes së kontratës së sigurimit me shoqëritë e sigurimeve, të përzgjedhura sipas rregullave për prokurimin publik.

4. Kontrata e sigurimit të jetës nga aksidentet të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin mbulon ngjarjet aksidentale, si më poshtë vijon:

- a) Vdekje si rezultat i aksidentit;
- b) Paaftësi e përhershme gjatë shërbimit ose aftësi e kufizuar gjatë shërbimit, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti gjatë shërbimit ose për shkak të tij;
- c) Paaftësi e përhershme gjatë shërbimit ose aftësi e kufizuar gjatë shërbimit, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;
- ç) Paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;
- d) Paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;
- dh) Shërbimet spitalore dhe/ose mjekësore në spitalet publike ose bazuar në marrëveshjen me shtetet e tjera për mbulimet shëndetësore që nuk ofrohen në spitalet publike të vendit.

5. Shuma e përcaktuar në kontratën e sigurimit, për çdo punonjës të siguruar, nuk mund të jetë më e ulët se 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

6. Tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në kontratën e sigurimit, por nuk mund të jetë më e ulët se 0.5%.

7. Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelën e koeficientëve të përfitimit ndaj dëmtimeve trupore, të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shërbejnë si kushte minimale, të detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 383, datë 13.5.2020**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË  
STANDARDEVE TË HARMONIZUARA  
SHQIPTARE ME KARAKTER  
REFERUES PËR SIGURINË E  
LODRAVE, TË VENDOSURA NË  
AMBIENTE PUBLIKE DHE PRIVATE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 12, dhe 5, të ligjit nr.10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare me karakter referues për sigurinë e lodrave, të vendosura në ambiente publike dhe private, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



2. Standardet e harmonizuara shqiptare, të paraqitura me numrat dhe tituj në listën sipas pikës 1, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente referencë për prezumimin e sigurisë së lodrave të vendosura në ambiente publike dhe private.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) dhe Inspektorati Shtetëror i

Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE ME KARAKTER REFERUES PËR SIGURINË E LODRAVE TË VENDOSURA NË AMBIENTE PUBLIKE DHE PRIVATE

Nr	Titulli i standardit në shqip	Viti i adoptimit si SSH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë FP ose me përkthim të plotë PP)
1	DS CEN/TR 16396:2012 Pajisjet e këndit të lojrave për fëmijë - Përgjigjet ndaj kërkesave për interpretimin e EN 1176:2008 dhe pjesëve të tij	2012	
2	DS CEN/TR 16467:2013 Pajisjet e këndit të lojrave të aplikueshme nga të gjithë fëmijët	2013	
3	SSH EN 1176-1:2017 Pajisje dhe sipërfaqe për sheshe lojrash - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme të sigurisë dhe metodat e testimit	2017	FP
4	SSH EN 1176-10:2008 Pajisje dhe sipërfaqe për sheshe lodrash - Pjesa 10: Kërkesat specifike shtesë për sigurinë dhe metodat e provës për pajisje lodër të mbyllur plotësisht	2008	FP
5	SSH EN 1176-11:2014 Pajisje dhe sipërfaqe për sheshe lojrash - Pjesa 11: Kërkesa specifike shtesë të sigurisë dhe metodat e provës për materiale kufizuese	2014	FP
6	SSH EN 1176-2:2017+ AC:2019 Pajisje dhe sipërfaqe për sheshe lojrash - Pjesa 2: Kërkesa specifike shtesë të sigurisë dhe metodat e testimit për lëkundjet	2017 2019	FP
7	SSH EN 1176-3:2017 Pajisje dhe sipërfaqe për sheshe lojrash - Pjesa 3: Kërkesa specifike shtesë të sigurisë dhe metodat e testimit për rrëshqitëset	2017	FP
8	SSH EN 1176-4:2017+AC:2019 Pajisje dhe sipërfaqe për sheshe lojrash - Pjesa 4: Kërkesa specifike shtesë të sigurisë dhe metodat e testimit për teleferikët	2017 2019	FP
9	SSH EN 1176-5:2019 Pajisje për sheshe lojrash - Pjesa 5: Kërkesa specifike shtesë të sigurisë dhe metodat e provës për karuselët	2019	FP



10	SSH EN 1176-6:2017+AC:2019 Pajisje dhe sipërfaqe për sheshe lojrash - Pjesa 6: Kërkesa specifike shtesë të sigurisë dhe metodat e testimit për pajisjet lëkundëse	2017 2019	FP
11	SSH EN 1176-7:2008 Pajisje për sheshe lojrash - Pjesa 7:Udhëzues mbi instalimin, inspektimin,mirëmbajtjen dhe operimin	2008	FP
12	DS CEN ISO/TR 8124-8:2016 Siguria e lodrave - Pjesa 8: Udhëzuesit e përcaktimit të moshës (ISO/TR 8124-8:2016)	2016	
13	DS CEN/TR 16918:2015 Siguria e lodrave - Mënyra e sjelljes së shqiptimit të fëmijëve në kontakt me lodrat	2015	
14	SSH EN 62115:2005/A12:2015 Lodrat elektrike – Siguria	2005 2015	FP
15	SSH EN 71-1:2014+A1:2018 Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	2014 2018	FP
16	SSH ISO 8124-1:2018 Siguria e lodrave - Pjesa 1: Aspekte të sigurisë lidhur me vetitë mekanike dhe fizike	2018	FP
17	DS CEN/TR 16879:2016 Vendosja e këndit të lojrave dhe mjediseve rekreative (argëtuese) te tjera - Këshilla mbi metodat për pozicionimin dhe ndarjen e tyre	2016	

## VENDIM

Nr. 389, datë 13.5.2020

### PËR MIRATIMIN E LISTËS DHE TË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE KADASTRALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 63, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë

#### VENDOSI:

#### I. SHËRBIMET DHE TARIFAT

1. Ky vendim përcakton shërbimet publike kadastrale që ofron Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në zbatim të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, mënyrën e aplikimit dhe tarifat standarde për çdo shërbim.

2. Lista e shërbimeve kadastrale dhe tarifat standarde janë sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Nga lista e shërbimeve të miratuara me këtë vendim, këshilli drejtues i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përzgjedh ato që mund të ofrohen edhe në mënyrë të përshpejtuar, si dhe tarifat e diferencuara që aplikohen në këtë rast. Vlera e tarifës së diferencuar, në asnjë rast nuk mund të kalojë dyfishin e vlerës së tarifës standarde.

4. Tarifa ka për qëllim të mbulojë shpenzimet për procedurat administrative që ASHK-ja kryen, pavarësisht nëse shërbimi i kërkuar nuk mund të realizohet për shkaqe të ligjshme, në përputhje me ligjin “Për kadastrën” dhe me legjislacionin në fuqi. Në rastet kur shërbimi refuzohet, vlera e parapaguar e tarifës nuk i kthehet subjektit të interesuar. Përfundimisht, për shërbimet që i nënshtrohen kamatëvonesës në regjistrim sipas aneksit 1, në rast refuzimi, kthehet vetëm shumica e kamatëvonesës.

5. Për shërbimet kadastrale që përfshijnë më shumë se një pasuri, tarifa si rregull do të aplikohet për secilën nga pasuritë. Përfundimisht, tarifimi nuk kryhet mbi bazë të numrit të pasurive, për shërbimet, si më poshtë vijon:



a) Shërbimi nr. 50 “lëshim kopje të planshetës së hartës kadastrale”, i cili tarifohet mbi bazë të numrit të planshetave të kërkuara;

b) Shërbimi nr. 52 “lëshim vërtetimi negativ/pozitiv”, i cili tarifohet në varësi të territorit (drejtorive vendore të ASHK-së) për të cilin kërkohet informacioni. Përfundimisht, kur vërtetimi kërkohet për të gjithë territorin e vendit, tarifa ndryshon sipas vlerës së përcaktuar në aneksin 1.

c) Shërbimin nr. 59, i cili tarifohet mbi bazën e numrit të faqeve të vendosura në dispozicion.

6. Të gjitha subjektet e interesuara, duke përfshirë edhe institucionet publike, e paraqesin kërkesën për shërbime kadastrale në rrugë digjitale-*on-line*, nëpërmjet platformës *e-Albania*. Tarifa e shërbimit paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për shërbim nga subjekti i interesuar ose në momentin e dhënies së pëlqimit për përfitimin e shërbimit nëpërmjet noterit.

7. Nëse ASHK-ja, gjatë trajtimit të kërkesës, konstaton se për realizimin e saj është e nevojshme të kryhen edhe shërbime të tjera mbi pasurinë (ose se kërkesa përfshin pasuri të tjera për të cilat nuk është paguar tarifë shërbimi), ia njofton ato kërkuarit, duke e njohur edhe me tarifën përkatëse të shërbimit. Shërbimet realizohen pasi kërkuari të ketë shlyer tërësinë e këtyre tarifave.

8. Të gjitha institucionet publike detyrohen të parashikojnë në projektbuxhetin e tyre shpenzimet e nevojshme për shlyerjen e tarifave të shërbimeve kadastrale.

Për shërbimet kadastrale që ofrohen në funksion të shpronësimeve për interes publik, organi qendror, vendor, apo subjekti privat përfitues i shpronësimit, detyrohet të parashikojë shumën e tarifave të shërbimeve kadastrale, si pjesë të shpenzimeve procedurale të tij.

9. Përfundimisht nga parapagimi i tarifave për shërbimet kadastrale me numër rendor 31;49;50;51;59;60;62;63;64, sipas aneksit 1, për efekt të realizimit të detyrimeve ligjore, institucionet, si më poshtë vijon:

a) Gjykatat;

b) Prokuroritë;

c) Policia e Shtetit;

ç) Institucionet që veprojnë në fushën e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

d) Autoriteti përgjegjës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive;

dh) Autoriteti shtetëror përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave;

e) Autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;

ë) Avokati i Shtetit

9.1 Për Avokatin e Shtetit, shërbimet kadastrale për të cilat nuk parapaguhet janë dhe ato me numër rendor 33 dhe 65, sipas aneksit 1.

Institucionet e përmendura në pikën 9, të këtij vendimi, e paraqesin kërkesën për shërbime kadastrale, pranë strukturave vendore të ASHK-së, në rrugë digjitale-*on-line*, në përputhje me pikën 6, të këtij vendimi.

9.2. Ato duhet t'i shlyejnë drejtorisë vendore të ASHK-së, çdo muaj, shumën e tarifave të shërbimeve kadastrale të ofruara në favor të tyre gjatë muajit paraardhës. Në rast mosshlyerjeje të detyrimit të plotë brenda dy javëve, drejtoria vendore e ASHK-së ndërpret ofrimin e shërbimeve ndaj institucionit, deri në pagimin e tij.

10. Për të gjitha rastet e tjera që nuk parashikohen në pikën 9, të këtij vendimi, institucioni publik, si dhe çdo subjekt tjetër kërkuar nuk përfitojnë shërbimet kadastrale pa paguar më parë tarifën përkatëse.

Përfundimisht, në përputhje me pikën 3, të nenit 25, të ligjit “Për kadastrën”, për regjistrimin e titujve të pronësisë që ASHK-ja miraton në bazë të legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, me akt nëligjor mund të parashikohen rregulla të veçanta për mënyrën e shlyerjes së tarifës së shërbimit nga përfituesit.

11. Shërbimet e korigjimit të gabimeve në kartelë, hartë kadastrale ose certifikatë nuk tarifohen kur gabimi vjen nga veprimtaria e ASHK-së, në përputhje me nenin 16, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”. I njëjti rregull zbatohet edhe për procedurat e përmirësimit që kryhen sipas kreut VI, të këtij ligji.

## II. DISPOZITA TË FUNDIT

12. Barrët hipotekore dhe sekuestrot mbi pasuritë e paluajtshme, të vendosura nga administrata tatimore dhe doganore, si dhe nga përmbaruesit gjyqësorë (shtetërorë dhe privatë), regjistrohen vetëm pasi të jetë paguar tarifa e shërbimit. I njëjti rregull zbatohet edhe për vendosjen në dispozicion të tyre të kopjeve të kartelave, hartave kadastrale, të informacionit dhe dokumentacionit mbi pasuritë e paluajtshme, si dhe për regjistrimin e kalimit të pronësisë nëpërmjet





konfiskimit të administratës tatimore/doganore apo aktit të përmbauesit gjyqësor.

13. Afati 30 (tridhjetë)-ditor pas të cilit aplikohen kamatëvonesat sipas nenit 25, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, si rregull llogaritjet nga data e miratimit të aktit të pronësisë/të drejtave reale. Përrjashtimisht, për titujt që burojnë nga aktet administrative, ose nga vendimet gjyqësore, nëse subjektet e interesuara provojnë se janë njoftuar në një datë të mëvonshme, llogaritja nis nga data e njoftimit të aktit/vendimit në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave Administrative ose Kodit të Procedurës Civile.

14. Përrjashtohen nga tarifat sipas këtij vendimi shërbimet kadastrale që ofrohen për regjistrimin e pasurive të subjekteve përfituese sipas aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. Vlera e këtyre tarifave kompensohet nga buxheti i shtetit në përputhje me pikën 3, të nenit 63, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”. Për këtë qëllim, ASHK-ja, brenda muajit tetor të çdo viti, i dërgon ministrisë përgjegjëse për financat, të dhënat për vlerën e tarifave të shërbimeve që u janë ofruar subjekteve

të mësipërme, për 9 muajt e parë të vitit ushtrimor, si dhe për tremujorin e fundit të vitit ushtrimor paraardhës. Kjo shumë parashikohet në projektbuxhetin e shtetit të vitit vijues, për t’u alokuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Procedurat e hollësishme për kompensimin e tarifave nga buxheti i shtetit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

15. Tarifat për shërbimet kadastrale bëhen publike në ambientet e çdo drejtorie dhe zyre vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

16. Vendimi nr.576, datë 29.8.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e listës së shërbimeve që ofron Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, dhe udhëzimi i përbashkët nr.5341/5, datë 7.9.2012, i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave “Për miratimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, shfuqizohen.

17. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

#### ANEKSI 1

#### LISTA E SHËRBIMEVE TE OFRUARA NGA AGJENCIA SHËTETËRORE E KADASTRES

Nr.	Lloji i shërbimit	Tarifa (Lekë)	Aplikimi, ose jo, i kamatëvonesës (10% e tarifës/ditë vonesë, por jo më shumë se 300 000 lekë)
1	Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ.	5000	PO
2	Regjistrimi i aktit për kalimin e pronësisë nga përmbauesi gjyqësor.	5000	PO
3	Regjistrimi i akteve me të cilat krijohet një shoqëri apo një subjekt tjetër i së drejtës, që ka në pronësi pasuri të paluajtshme apo gëzon të drejta të tjera reale.	5000	PO
4	Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të fituar me parashkrim fitues.	5000	PO
5	Regjistrimi i kontratës së shitjes	3500	PO
6	Regjistrimi i kontratës së dhurimit	3500	PO
7	Regjistrimi i kontratës së shkëmbimit	3500	PO
8	Regjistrimi i heqjes dorë nga pronësia	3500	PO
9	Regjistrimi i aktit të trashëgimisë	1000	PO
10	Regjistrimi i pjestimit të pasurisë së paluajtshme me vendim gjykate/ apo marrëveshje noteriale.	1000	PO
11	Regjistrimi i titujve "në përdorim"	3500	PO
12	Regjistrimi i uzufuktit	3500	PO
13	Regjistrimi i kontratës së qerasë/nënqerasë	3500	
14	Regjistrimi i kontratës së qerasë për pasuritë bujqësore, me afat mbi nëntë vjet	3500	PO
15	Regjistrimi i kontratës së enfitëozës	3500	PO
16	Regjistrimi /ndryshim/ shuarje Servituti	1000	PO
17	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë se dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për	7500	PO



	kredi me vlere deri në 1.000.000 lekë		
17/1	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlere 1 000.000 - 10 000 000 lekë	15000	PO
17/2	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlere mbi 10 000 000 lekë	25000	PO
18	Regjistrim i hipotekës gjyqësore - për garantimin e vlerës së detyrimit, të përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë, deri në 1.000.000 lekë	7500	PO
18/1	Regjistrim i hipotekës gjyqësore - për garantimin e vlerës së detyrimit, të përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë, nga 1 000.000 - 10 000 000 lekë	15000	PO
18/2	Regjistrim i hipotekës gjyqësore - për garantimin e vlerës së detyrimit, të përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë, mbi 1.000.000 lekë	25000	PO
19	Regjistrim i kontratave të tjera të hipotekës	1000	PO
20	Regjistrimi i cedimit (kalimit) të hipotekës	1000	PO
21	Regjistrim i hipotekës ligjore	1000	JO
22	Regjistrim i barrës hipotekore në favor të administratës tatimore, ose doganore	1000	JO
23	Fshirje e hipotekës (kontraktore, gjyqësore, apo ligjore)	1000	JO
24	Regjistrimi i lejes së ndërtimit	2000	PO
24/1	Regjistrimi i lejes së zhvillimit	2000	PO
25	Regjistrimi i përkohshëm i karabinasë	6500	PO
26	Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja.	6500	PO
27	Regjistrimi i Aktit të Bashkëpronësisë për objektet në bashkëpronësi të detyrueshme	5000	PO
28	Regjistrim i kontratës së shitjes, shkëmbimit, ose dhurimit, me rezervë/kusht të pasurisë së paluajtshme	1000	PO
29	Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme	1000	JO
30	Pasqyrim i bashkëpronësisë bashkëshortore në regjistrimet e mëparshme	1000	JO
31	Regjistrimi i sekuestros mbi pasurinë	1000	JO
32	Regjistrimi i marrëveshjeve dhe akteve lidhur me kufijtë e pasurive të paluajtshme	2500	PO
33	Regjistrim i vendimit gjyqësor për vendosjen e masës së sigurimit të padisë	1000	PO
34	Regjistrim i aktit noterial për pezullimin e veprimeve të regjistrimit	1000	PO
35	Regjistrim i akteve noteriale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të tualit apo me subjekte të treta	3500	PO
36	Regjistrim i kërkesë padisë	1000	JO
37	Regjistrim i të drejtës së parablerjes	1000	JO
38	Regjistrimi i rentës jetore	1000	JO
39	Regjistrim i legut	1000	JO
40	Regjistrim i prokurës	1000	JO
41	Regjistrim i pemëve dhe pasurive natyrore	1000	JO
42	Saktësim i kufijve të pasurisë tokë	2500	JO
43	Saktësim i kufijve të pasurisë ndërtesë	2500	JO
44	Regjistrim fillestar i pasurisë së paluajtshme pa rilevim e azhurnim nga ASHK	5000	JO
45	Regjistrim fillestar i pasurisë së paluajtshme me rilevim e azhurnim nga ASHK	10000	JO
46	Rilevim/Verifikim në terren i pasurisë	5000	JO
47	Hartim i planit të rilevimit	5000	JO
48	Kalim i regjistrimit nga regjistrat hipotekore në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, para ose pas përfundimit të regjistrimit fillestar.	1000	JO
49	Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale	1000	JO
50	Lëshim kopje të planshetës të hartës kadastrale	5000 lekë/planshetë	JO
51	Lëshim kopje karteletë të pasurisë	1000	JO
52	Lëshim vërtetimesh (negativ/pozitiv)	300leke/drejtori ; 3000 lekë / për të gjithë territorin	JO



53	Lëshim certifikate pronësie	1500	JO
54	Lëshim vërtetim pronësie	1500	JO
55	Lëshimi i një certifikate të re kur ka humbur apo është dëmtuar certifikata e marrë.	1000	JO
56	Korrigjim gabimesh në kartelë	1000	JO
57	Korrigjim gabimesh në hartën kadastrale	1000	JO
58	Korrigjim gabimesh në certifikatën e pasurisë së paluajtshme	1000	JO
59	Kopje te vërtetuara të dokumenteve tekniko-ligjore, në të cilat bazohet regjistri i pasurive të paluajtshme / faqe	200 lek/faqe	JO
60	Konsultim i kartelës së pasurisë së paluajtshme	700	JO
61	Pozicionim i veprës infrastrukturore	2000	JO
62	Verifikimi online i gjendjes juridike të pronësisë dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme	600	JO
63	Informacion zyrtar i pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)	2000	JO
64	Dhënie e informacionit koordinativ për çdo pasuri të paluajtshme.	1000	JO
65	Regjistrim i pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë	1000	PO

**VENDIM**  
**Nr. 390, datë 13.5.2020**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË  
STATUSIT, NGA KATEGORIA E  
RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË  
“TOKË URBANE”, TRUALL, TË NJË  
SIPËRFAQEJE TË PASURISË ME  
NUMËR 242/2, ZONA KADASTRALE  
1031, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë

urbane”, truall, për sipërfaqen prej 150 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë me numër 242/2, zona kadastrale 1031, Bashkia Durrës, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për sipërfaqen prej 150 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë me numër 242/2, zona kadastrale 1031, Bashkia Durrës.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Durrës dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

**Edi Rama**

Nr. rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurise	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Sip. ndërtimore m <sup>2</sup>	Emërtimi i strukturës
1	Durrës	Durrës	1031	Arapaj	242/2	1310	150 (kthehet ne truall)	Strukturë me aktivitet prodhimin dhe përpunimin e ullirit, 1 kat.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË**      449651  
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Digitaly i gjeneruar nga sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme të Republikës së Shqipërisë. Data: 12.03.2020

Zyra e Regjistrimit DURRES      Zona Kadastrale Nr. 1031  
 Numri i Pasurisë 242/2      Volumi 5      Faqe 29  
 Adresa e Pasurisë ARAPAJ  
 Lloji i Pasurisë ARE  
 Sipërfaqja Totale 1310 m<sup>2</sup>  
 Nga kjo : Sa Truall \_\_\_\_\_      Nga kjo : Sa Ndërtesa \_\_\_\_\_  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes \_\_\_\_\_

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>PETRIT</u>		<u>TROPLINI</u>	<u>B</u>	<u>ARAPAJ</u>
<u>SHAJE</u>		<u>TROPLINI</u>	<u>B</u>	
<u>BLENDAR</u>		<u>TROPLINI</u>	<u>B</u>	

- është pronar i \_\_\_\_\_  
 - janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart TC PASURISË 242/2  
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi \_\_\_\_\_  
 - kufizimet e pasurisë janë : V 194 , L 242/3 , J 242/14 , P 242/11

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i drejtuesi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme më datë 09.03.2020.**

Leshuesi i çertifikatës  
**BEDRI LUKU**  
 (Signature and Stamp)

Data e lëshimit të çertifikatës  
12.03.2020



### HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

<p>ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME</p> <p style="text-align: center;">DURRES</p> <p>REGJISTRUESI I RRETHIT</p> <p style="text-align: center;"><b>BEDRI LUKU</b></p>	<p><b>A. IDENTIFIKIMI I PASURISE</b></p> <p>ZONA KADASTRALE <u>1031</u> NR.PASURISE <u>242/2</u> VOL. <u>5</u> FQ. <u>29</u></p> <p>INDEKSI I HARTES <u>K-34-100(17-B)</u> SHKALLA <u>1:2500</u> SIP = <u>1320m<sup>2</sup></u></p> <p>ADRESA E PASURISE : Rrethi Durres QRF <u>Arapaj</u></p> <p>Rr/L _____ PIG _____ Sh <u>K</u> Ap _____</p> <p><b>B. KUFIZIME</b></p> <p>V. PASURIA Nr. <u>194</u></p> <p>L. PASURIA Nr. <u>242/3</u></p> <p>J. PASURIA Nr. <u>242/14</u></p> <p>P. PASURIA Nr. <u>242/11</u></p> <p><b>C. PRONARI</b></p> <p style="text-align: center;"><u>Petrit Troplini etj</u></p> <p><b>D. Data</b> <u>20/2/2012</u> Ora <u>19:00</u></p> <p style="text-align: right;"><u>S. Memaj</u></p>
--	--

REZ. ARAPAJ



**PLANVENDOSJA E STRUKTURES SH.1:500**  
**LEJE NDRYSHIMI**  
OBJEKTI STRUKTURE ME AKTIVITET TE PRODHIMIT DHE PERPUNIMIT TE ULURIT 1 KAT  
ADRESA: AKAPALJESIA ADMINISTRATIVE RRASHIBU LL DURRES  
ZHVILLIM: PETRI SHAJE & BLEDAR TROPLINI

SH.1:500

**FRAGMENT RILEVIMIT SH.1:500**

**MIRATOHET**  
PER BASHKINE DURRES  
KRYETARI  
ING. VANGJUSH DAKO

DREJTORI I DREJTORISE SE  
PLANIFIKIMIT DHE  
KONTROLLIT TE TERRITORIT  
DR. ADHURIM GEHAJAJ

**POZICIONI KADASTRAL SH.1:2500**

**POZICIONI NE ZONEN URBANE**

**PERSHKRIM I KERKESES PER LEJE**

Objekti qe propozohet te ndertohet eshte struktur e me karakterizim me te pak perperqurimi e abilit dhe qendron e kusht te abilit. Trokës ka te perqurimi qendror ne veci te pones, se sa te mijaqja me ulës dhe per kate abilit e domosdoshme rigjira e kete leje te perqurimi te abilit. Per abilitimi e ketej, supozimi fardis Trokës ka mosi grant nga Ministria e Bujqësisë dhe Ndarjes per mijaqje e abilit.

KONDIÇIONET URBANE	
Supërfaqe parcelë	1310 m <sup>2</sup>
Kufiri i abilitit te ndryshimit	1310 m <sup>2</sup>
Supërfaqe ndertimit	150 m <sup>2</sup>
Supërfaqe ndertimit totale	150 m <sup>2</sup>
Katë ndertimit	11.5 %
Katë	0.11
Nr. Kat mbulim teke	1K
Nr. Kat nerrteke	0K
Volumi objektit	075 m <sup>3</sup>
Lartësia e pergjithshme	4 m 5m

DISTANCAI NGA SRESHI NDERTIMIT	
Distanca nga V (kufi prones)	11.50 m & 14.90 m
Distanca nga J (kufi prones)	25.50 m & 26.20 m
Distanca nga L (kufi prones)	9.40 m & 7 m
Distanca nga P (kufi prones)	7.00 m

**VENDIM**  
**Nr. 391, datë 13.5.2020**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”, TRUALL, TË NJË SIPËRFAQEJE TË PASURISË ME NUMËR 64/40, ZONA KADASTRALE 3743, BASHKIA PATOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për sipërfaqen prej 3 160 m<sup>2</sup>, pjesë e

pasurisë me numër 64/40, zona kadastrale 3743, fshati Verbas, Njësia Administrative Zharrës, Bashkia Patos, sipas certifikatës të pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Drejtorja e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Fier, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për sipërfaqen ndërtimore sipas lidhjes nr. 1, të pasurisë me numër 64/40, zona kadastrale 3743, fshati Verbas, Njësia Administrative Zharrës, Bashkia Patos.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Fier dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**



## Lidhja nr. 1

Nr. rend.	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Sip. Ndërtimore m <sup>2</sup>	Emërtimi i strukturës
1	Fier	Patos	3743	Verbas	64/40	8880	3160	Dy kabanone 1kat, për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË**      2004121  
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Z.V.R.P.P. FIER      Zona Kadastrale Nr. 3743  
 Zyra e Regjistrimit      Numri i Pasurisë 64/40      Volumi 4      Faqe 237

Adresa e Pasurisë      VERBAS  
 ARE

Lloji i Pasurisë      8880.00      m2

Sipërfaqja Totale

Nga kjo : Sa Truall      Nga kjo : Sa Ndërtesa

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
SHOQERIA DRIZA SH.P.K			1/1	FIER

- është pronar i pasurisë me numër 64/40

- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart

- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi

- kufizimet e pasurisë janë : V \_\_\_\_\_, L \_\_\_\_\_, J \_\_\_\_\_, P \_\_\_\_\_

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga j (të) interesuari (t) më datë 20/8/2019 Nr. 17332**

Data e lëshimit të çertifikatës  
30/8/2019

Lëshuesi i çertifikatës  
REGJISTRUESI  
**ERVIN BUSHI**





**REGJIS I KIMI I**  
(fragment)

**KRYEMINISTRIA  
E SHTETITORË E KADASTRES  
FIER**

**DREJTOR  
FIER**

**ERVIN BUSHI**  
Vula / Firma

**A. IDENTIFIKIMI I PASURISE :**

ZONA KADASTRALE 3743, NR. I PASURISE 644901 fq \_\_\_\_\_

INDEKSI HARTES Pr. 34-112-(212-S) SHKALLA 1:2500

ADRESA PASURISE : Rrethi FIER RIF VERBËS

Rr/L \_\_\_\_\_ P/G \_\_\_\_\_ Sh \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ Ap \_\_\_\_\_

**B. KUFIZIMET** **C. PRONARI/ET**

V. 6417 SHOQERIA "SRIOR, SHRL"

L. \_\_\_\_\_

J. 6438, 6439

P. 6425, 6427

D.Data: 28/08/2019 Ora: 12<sup>00</sup>

S. Hoxha Veri





**IDENTIFIKIMI I PASURISE**

Vol. 4, Fq. 237

Kadastrale: 3743 NR i PASURISE: 64/40 → Vizon nga: Vol. , Fq. , deri në: Vol. , Fq. ,

Adresa e Hartes: K-34-112-212- Vizion në: Vol. , Fq. , deri në: Vol. , Fq. ,

Adresa e Pasurisë: Rrethi **FIER** QF VERBAS PERFUNDIMTARE(data):

Rr./L. P/G SH K Ap

**SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE**

Lloji i Pasurisë: **ARE** Brenda V.K.N. : PO , Ref. PL

RREGULL

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale; sa Trual	Nga Sip. Trual; sa Ndërtesë	UES
1. 8,880.00 m <sup>2</sup> Ref. 09000758	1. m <sup>2</sup> Ref.	1. m <sup>2</sup> Ref.	Per pjesen e përbashkët: <b>PALLAT</b>
2. m <sup>2</sup> Ref.	2. m <sup>2</sup> Ref.	2. m <sup>2</sup> Ref.	Kuota e pjesmarjes: %
3. m <sup>2</sup> Ref.	3. m <sup>2</sup> Ref.	3. m <sup>2</sup> Ref.	Nr i Pasurise (pallat):
4. m <sup>2</sup> Ref.	4. m <sup>2</sup> Ref.	4. m <sup>2</sup> Ref.	Vol. Faqe.

Pëshkrim i veçantë:

**SEKSIONI I PRONESISE**

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
06300/58	30/08/2019	SHOQERIA 'DRIZA' SH.P.K. -				1	FIER		30/08/2019		<i>[Signature]</i>

indiv. individ, person fizik ose juridik; F - përfaqesues i familjes; B - bashkëpronar (%)



**VENDIM**  
**Nr. 392, datë 13.5.2020**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË  
STATUSIT, NGA KATEGORIA E  
RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË  
“TOKË URBANE”, TRUALL, TË NJË  
SIPËRFAQEJE TË PASURISË ME  
NUMËR 108/169, ZONA KADASTRALE  
2420, BASHKIA POGRADEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për sipërfaqen prej 555 m<sup>2</sup>, pjesë e

**Lidhja nr. 1**

Nr. rendor	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Sipërfaqja ndërtimore m <sup>2</sup>	Emërtimi i strukturës
1	Korçë	Pogradec	2420	Leshnicë	108/169	3399	355	Kantinë për prodhim vere, 1 kat.

pasurisë me numër 108/169, zona kadastrale 2420, fshati Leshnicë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për sipërfaqen ndërtimore prej 555 m<sup>2</sup>, sipas lidhjes nr. 1, të pasurisë me numër 108/169, zona kadastrale 2420, fshati Leshnicë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**

**Edi Rama**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË  
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1847047

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. POGRADEC Zona Kadastrale Nr. 2420  
 Numri i Pasurisë 108/169 Volumi 10 Faqe 123  
 Adresa e Pasurisë LESHNICE  
 Lloji i Pasurisë ARE  
 Sipërfaqja Totale 3399.00 m<sup>2</sup>  
 Nga kjo : Sa Trruall \_\_\_\_\_ Nga kjo : Sa Ndërtesa \_\_\_\_\_  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes \_\_\_\_\_ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Mësonia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
SHOQERIA	"OPTIMUM" 3	SHPK	1/1	CERRAVI

- pasurisë me numër 108/169
- është pronar i \_\_\_\_\_
  - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart \_\_\_\_\_
  - është përtfaqësues i familjes e cila ka në pronësi \_\_\_\_\_
  - kufizimet e pasurisë janë : V 86 L 108/58 J 110 P 108/54

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me  
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të  
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së  
paraqitur nga i (të) interesuari (t)  
me datë 17/6/2019 Nr. 2558

Data e lëshimit të çertifikatës  
14/6/2019






**HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT**

(Fragmente)

<p>AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS DREJTORIA VENDORE POGRADEC</p> <p><b>DREJTOR</b> Natalia VILLO</p>  <p>HARTOGRAF D. MANE LARI</p>	<p>A. IDENTIFIKIMI I PASURISE</p> <p>ZONA KADASTRALE <b>2420</b> NR. I PASURISE <b>108/ 169</b> Vol. 10 Fq. 123</p> <p>INDEKSI I HARTES <b>K-34-114-(103-D)</b>. SHKALLA 1:1000</p> <p>ADRESA E PASURISE: Rrethi <b>Pogradec</b> Q/E <b>Leshnice</b></p> <p>Rr./L. _____ PIC _____ Sh _____ K _____ Ap _____</p>	
	<p>B. KUFIZIMET</p> <p>V. 86</p> <p>L. 108/56</p> <p>J. 110</p> <p>P. 108/54</p>	<p>C. PRONARI/ET</p> <p><b>(1) "OPTIMUM 3" SHPK</b></p>
	<p>D. Data: / / 2019</p>	
	<p>Ver</p>	





**VENDIM**  
**Nr. 393, datë 13.5.2020**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË  
STATUSIT, NGA KATEGORIA E  
RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË  
“TOKË URBANE”, TRUALL, TË NJË  
SIPËRFAQEJE TË PASURISË ME  
NUMËR 51/56, ZONA KADASTRALE  
3428, BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë

**Lidhja nr. 1**

Nr. rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Sip. ndërtimore m <sup>2</sup>	Emërtimi i strukturës
1	Shkodër	Shkodër	3428	Shtoj i Ri	51/56	2938	565	Ndërtim, objekt 1 kat për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin bujqësor, përfshirë dhe ato për tharjen dhe trajtimin paraprak të produkteve bujqësore

urbane”, truall, për sipërfaqen prej 565 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë me numër 51/56, zona kadastrale 3428, Bashkia Shkodër, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Shkodër, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të sipërfaqes prej 565 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë me numër 51/56, zona kadastrale 3428, Bashkia Shkodër.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Shkodër dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË** 1678049  
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. SHKODËR Zona Kadastrale Nr. 3428  
 Numri i Pasurisë 51/56 **Bardhi** Digitally signed by **Bardhi Shllaku** 212  
 Adresa e Pasurisë SHTOJLRI Date: 2019.02.08  
 Lloji i Pasurisë PEMETORE **Shllaku** 18:58:10 +01'00'  
 Sipërfaqja Totale 2938.00 m2  
 Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
GJERGJI-	IMPEX	SHPK	1/1	BRETHINAT

- është pronar i pasurisë me numër 51/56  
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart    
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi    
 - kufizimet e pasurisë janë : V  , L  , J  , P  

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga I (të) Interesuari (t) më datë 8/1/2018 Nr. 144**

Lëshuesi i Çertifikatës  
 REGJISTRIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME  
 SHKODËR  
 ( **SHKODËR** )  
 Z.V.R.P.P. SHKODËR

Data e lëshimit të çertifikatës  
10/1/2018




### HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

**ZYRA E REGJISTRIMIT  
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME  
SHKODER**

**REGJISTRUES:**

*Inq. Vitorë ISUF*

**A.IDENTIFIKIMI I PASURISE**  
 ZONA KADASTRALE: 3428  
 NUMRI I PASURISE: 51/56 VOL: 7 FO: 212  
 INDEKSI I HARTES : K-34-64-(161-C) SHKALLA 1:2.500  
 ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER Q/F Shtoiç/LRI  
 Rr/L : \_\_\_\_\_ P/G Sh K Ap \_\_\_\_\_  
**B.KUFIZIMET**  
 V. 51/92 \_\_\_\_\_ C.PRONARI  
 L. 199 \_\_\_\_\_ "Gjergji- IMPEX" sh.p.k  
 J. 51/87,88. \_\_\_\_\_ Sip.tot.=2938 m2 pemtore.  
 P. 51/63 \_\_\_\_\_  
 Date : 10/01/2018



3428



Date 7.11.1994 **KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME** Vol 7 \_\_\_\_\_, Fq 212 \_\_\_\_\_

**IDENTIFIKIMIT TE PASURISE** --> Vizon nga Vol \_\_\_\_\_, Fq \_\_\_\_\_

Kadastrale: 3428 NR.I PASURISE: 51/56 Vizon ne: Vol \_\_\_\_\_, Fq \_\_\_\_\_ deri ne Vol \_\_\_\_\_, Fq \_\_\_\_\_ -->

Indeksi i Hartes: K-34-64-161-C Adresa e Pasurise: Rrethi SHKODER Q/F SHTOJ I RI **PERFUNDIMTARE (data):** \_\_\_\_\_

Rr/l. \_\_\_\_\_ P/G \_\_\_\_\_ SH \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ Ap \_\_\_\_\_

**B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE**

Lloji i Pasurise: PEMETORE Brenda V.K.N. : JO , Ref: \_\_\_\_\_

Sip. Totale e Pasurise:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Nderest	Per pjesen e përbashkët:
1. <u>2,938.00</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>00001287</u>	1. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	1. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	<u>PALLAT</u>
2. Përmbauesi gjyqësor privat duhet të ketë integritet të lartë personal dhe profesional, të veprojë me ndershmëri, drejtësi, kujdes dhe përkushtim.

3. Përmbauesi gjyqësor privat duhet të shmangë çdo sjellje të papërshtatshme, që bie në kundërshtim me ligjin dhe këtë kod, si edhe ato veprime që mund të dëmtojnë ose të krijojnë dyshime mbi figurën e tij profesionale dhe morale.

4. Përmbauesi gjyqësor privat, në ushtrim të kompetencave të tij, duhet të tregohet objektiv, i pavarur, i paanshëm dhe i ndërgjegjshëm për detyrimet etike e profesionale. Paanshmëria, ndershmëria dhe pavarësia.

5. Përmbauesi gjyqësor privat duhet të shmangë çdo veprim, mosveprim arbitrar apo çdo trajtim preferencial, si dhe të jetë i pandikuar nga çdo interes tjetër, personal, politik, familjar dhe shoqëror.

6. Përmbauesi gjyqësor privat duhet të shmangë, në çdo rast, diskriminimin për shkak të racës, gjinisë, besimit fetar, etnisë, ose çdo lloj diskriminimi tjetër.

7. Përmbauesi gjyqësor privat duhet të refuzojë korrupsionin, marrëveshjet e fshehta dhe çdo veprim tjetër që dëmton klientin, ose që dukshëm është i dëmshëm për njërin nga palët.

8. Përmbauesi gjyqësor privat ushtron veprimtarinë e tij me përgjegjshmëri profesionale

dhe me detyrimin e informimit të klientit mbi çdo veprim që është duke kryer.

9. Përmbauesi gjyqësor privat duhet të hartojë aktet përmbaimore në mënyrë të qartë dhe të pastër, sipas rregullave të parashikuara në ligj.

10. Përmbauesi gjyqësor privat refuzon bindjen me dhunë, praktikat e pandershme, evazionin tatimor, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, dhe çdo lloj aktiviteti tjetër kriminal.

### Neni 6 Parimi i konfidencialitetit dhe sekretit profesional

1. Përmbauesi gjyqësor privat dhe përmbauesi gjyqësor privat zëvendësues duhet të respektojnë të drejtën e konfidencialitetit të klientëve dhe të personave të interesuar.

2. Përmbauesi gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të veprimtarisë duhet të mbajë një qëndrim të paanshëm, të ruajë një pozicion etik në lidhje me interesat e klientit/palëve, duke vendosur një disiplinë që garanton siguri dhe besim për ta.

3. Sekretet profesional nuk është absolut, ai është në varësi të interesit të përgjithshëm dhe të së mirës së përbashkët, pasi përmbauesi gjyqësor privat do duhet të tregojë përmbajtjen e arkivave të tij vetëm në procedurat e përcaktuara me ligj.

4. Përmbauesi gjyqësor privat duhet të marrë parasysh të drejtat ose interesat legjitime të klientit, ose palëve që kërkojnë qasje në arkivat e tyre dhe jep informacion në përputhje me ligjin “Për shërbimin përmbaimit privat” dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

### Neni 7 Përgjegjësitë në ushtrimin e profesionit

1. Përmbauesi gjyqësor privat është përgjegjës ndaj klientit/palëve që u shërben. Ai duhet të ushtrorë kujdesin e duhur profesional për identifikimin e të gjithë mbajtësve të ligjshëm të të drejtave, duke u shpjeguar atyre të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga veprimet e tij, duke i këshilluar në lidhje me pasojat juridike, në lidhje me të drejtat dhe interesat e tyre.

2. Gjatë hartimit të akteve përmbaimore, përmbauesi gjyqësor privat pasqyron dhe vërteton vullnetin e ligjshëm të klientit/palëve, deklaratat dhe faktet e paraqitura prej tyre.





3. Përmbauesi gjyqësor privat duhet të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë korrekte dhe brenda kompetencave lëndore dhe territoriale, të përcaktuara në ligjin “Për shërbimin përmbauesor privat”.

4. Përmbauesi gjyqësor privat është përgjegjës për pagesën e detyrimeve që rrjedhin nga veprimtaria përmbauesore, të përcaktuara nga Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

### Kreu III Shërbimi përmbauesor

#### Neni 8 Refuzimi në dhënien e shërbimit përmbauesor

1. Në cilësinë e zyrtarit publik, përmbauesi gjyqësor privat refuzon kryerjen e veprimeve për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv vetëm në rastet e mëposhtme:

a) Kur veprimi është në kundërshtim me ligjin ose rendin publik.

b) Kur konstaton që dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë, objekti ose përmbajtja e tij është në kundërshtim me ligjin dhe parimet e përgjithshme të së drejtës.

#### Neni 9 Zyra përmbauesore

1. Zyra përmbauesore organizohet në mënyrë të pavarur dhe është nën përgjegjësinë e përmbauesit gjyqësor privat.

2. Zyra duhet të ketë kushtet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë përmbauesore, sipas udhëzimeve përkatëse.

#### Neni 10 Paraqitja e përmbauesit gjyqësor privat

Përmbauesi gjyqësor privat duhet të paraqitet me një veshje formale, dhe të mbajë të ekspozuar në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit i cila prezanton funksionin publik që ai ushtron.

Neni 11

#### Regjistrat e çështjeve përmbauesore

1. Regjistrat e çështjeve përmbauesore, dokumentet dhe arkivat, administrohen nga përmbauesit gjyqësor privat dhe janë objekt i konfidencialitetit dhe fshehtësisë profesionale.

Neni 12

#### Mjetet teknologjike

Zyra e përmbauesit gjyqësor privat duhet të jetë e pajisur me mjete teknologjike dhe materialet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 13

#### Veprimtaria përmbauesore

1. Veprimtaria përmbauesore ushtrohet në mënyrë personale dhe të pavarur nga çdo përmbaues gjyqësor privat/përmbaues gjyqësor privat zëvendësues të cilët janë të pajisur me licencën individuale të ushtrimit të veprimtarisë përmbauesore, nën përgjegjësinë individuale të tyre.

2. Përmbauesi gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, i nënshtrohet inspektimeve dhe kontrolleve të bëra nga Ministria e Drejtësisë dhe/ose nga organet e Dhomës, sipas përcaktimeve në ligjin “Për shërbimin përmbauesor privat”.

Neni 14

#### Anëtarësia

1. Përmbauesi gjyqësor privat i licencuar dhe i regjistruar në regjistrat e përmbauesve gjyqësor privat është anëtar i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

2. Përmbauesi gjyqësor privat/përmbaues gjyqësor privat zëvendësues mund të jetë edhe anëtar i shoqatave profesionale në fushën e përmbauesit.



## Kreu IV

**Përgjegjësitë, marrëdhënia me kolegët dhe bashkëpunimi institucional**

## Neni 15

**Marrëdhëniet e përmbaruesit gjyqësor privat me kolegët**

1. Në marrëdhëniet me kolegët përmbaruesi gjyqësor privat, duhet të veprojë në përputhje me parimet e bashkëpunimit të drejtësisë dhe solidaritetit.

2. Sjellja e një përmbaruesi gjyqësor privat kundrejt kolegëve të tij duhet të jetë etike, si dhe të ketë për qëllim bashkëpunimin, unitetin dhe solidaritetin, duke nxitur shkëmbimin e mbështetjes, shërbimeve dhe këshillave.

3. Konfliktet ndërmjet përmbaruesve gjyqësorë privatë në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë profesionale përmbarimore rregullohen, për aq sa është e mundur, nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat. Përmbaruesi gjyqësor privat mund të kërkojë, në çdo rast të nevojshëm ndërhyrjen e saj.

## Neni 16

**Bashkëpunimi me sistemin gjyqësor**

1. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, si organ përfaqësues i të gjithë përmbaruesve gjyqësorë privatë të Shqipërisë, bashkëpunon me autoritetet gjyqësore në përmbushjen e funksionit të saj publik dhe në kuadër të kompetencave të caktuara me ligj, me qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e zbatimit të drejtësisë dhe paqes sociale.

2. Përmbaruesi gjyqësor privat, si praktikues i ligjit, i ngarkuar me autoritetin e nevojshëm publik, bashkëpunon me autoritetet gjyqësore në përmbushjen e funksionit të tij dhe në kuadër të kompetencave të caktuara nga ky Kod, si dhe nga aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, me qëllim zbatimin e drejtësisë dhe paqes sociale.

## Neni 17

**Konflikti i interesit**

1. Përmbaruesi gjyqësor privat është i detyruar të mos pranojë kërkesën për vënie në ekzekutim ose të heqë dorë nga ekzekutimi kur ky ka filluar, nëse ai ka marrë dijëni ose duhet të kishte marrë dijëni për ekzistencën e një shkakut, që tregon një konflikt interesi, kur:

a) ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, në çështjen për të cilën kërkohet ose ka filluar ekzekutimi;

b) përmbaruesi gjyqësor privat është kujdestar apo përfaqësues i njëres prej palëve në proces ekzekutimi;

c) ai vetë, bashkëshorti/ja ose të afërmit e tij deri në shkallën e dytë janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njëren prej palëve në proces ekzekutimi;

ç) ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.

## Neni 18

**Bashkëpunimi me institucionet publike, private dhe organizatat e tjera**

1. Përmbaruesi gjyqësor privat, pa cenuar detyrën e tij të ruajtjes së fshehtësisë profesionale, bashkëpunon me institucionet dhe agjencitë shtetërore për funksionet e deleguara dhe në kuadër të kornizës së marrëdhënieve zyrtare të lidhura me fushëveprimin e tij.

2. Përmbaruesi gjyqësor privat bashkëpunon me institucionet dhe agjencitë e tjera publike dhe private, kur një gjë e tillë është pjesë e ushtrimit të autoritetit publik, në pajtim me detyrat e lidhura me funksionin e tij dhe duke u siguruar se edhe ata, me të cilët bashkëpunon, janë në pajtim me këto detyra.

3. Përmbaruesi gjyqësor privat duhet të reflektojë një sjellje etike profesionale gjatë komunikimeve me institucionet publike ose private ose përfaqësuesit e tyre.



## Kreu IV

**Shkeljet dhe masat disiplinore**

## Neni 19

**Shkeljet dhe masat disiplinore**

1. Masat disiplinore për shkeljet e këtij Kodi janë ato të parashikuara në ligjin nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor privat”, në nenin përkatës të masave disiplinore.

2. Ky Kod rregullon dhe sanksionon shkeljet deontologjike brenda profesionit të përmbartuesit gjyqësor privat, pa cenuar sanksionet për shkelje të rregullave materiale ose rregullave të një natyre tjetër (civile, penale, administrative) të kryer nga përmbartuesi gjyqësor privat.

## Kreu V

**Dispozitat përfundimtare**

## Neni 20

**Ndryshimet**

Kodi hartohet dhe ndryshohet në përputhje me ligjin “Për shërbimin përmbartimor privat”.

Kodi i etikës botohet në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.

**VENDIM****Nr. 60, datë 8.4.2020**

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2020**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar, të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, bordi i Entit

Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin mars 2020,

Konstatoi se:

- FSHU sh.a me shkresën nr. 3185 Prot., datë 1.04.2020, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin mars 2020.

- FSHU sh.a deklaroi se sasia e energjisë elektrike të blerë për muajin mars 2020 për klientët që furnizohen nga FMF është prokuruar vetëm në treg të parregulluar.

- Nga procedurat të cilat janë kryer për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar për periudhën 1-31 mars 2020, për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, janë marrë në konsideratë 5 procedurat të cilat janë realizuar gjatë muajit mars.

- Për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë marrë në konsideratë:

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në Vendimin nr. 198, datë 12.12.2019 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020” është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në Vendimin nr. 199, datë 12.12.2019 të bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020” është 1.5 lekë/kWh.

- Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë Lekë/Euro të ditëve kur shoqëria ka realizuar procedurat e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar.



## Çmimi i FMF-së për muajin Mars 2020

Mars 2020		Aplikimi FSHU sh.a.	Propozimi i ERE
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	5.391
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.16</u>
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	5.55
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
<b>Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA</b>		<b>Leke/kWh</b>	<b>9.59</b>
			<b>9.56</b>

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës llogaritëse rezulton që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2020 të jetë 9.56 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

## VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.56 lekë/kWh për muajin Mars 2020.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 61, datë 8.4.2020**

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE”  
SHPK, PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 13, pika 2, germa “a”, dhe të pikës 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215, datë 20.12.2019; si dhe të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar me vendimin nr. 215, datë 20.12.2019, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi refuzimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 31, datë 21.2.2020, Bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bazuar në nenet 8, 9 dhe 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien,



modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215/2019, pas fillimit të procedurës, shoqërisë iu dërgua shkresa nr. 246/1 prot., datë 28.2.2020, për plotësimin e dokumentacionit dhe për depozitimin e informacionit shtesë.

- Me shkresën nr. 62/10 prot., datë 25.2.2020, është bërë njoftimi në media dhe pas përfundimit të afatit të pritjes së objeksioneve apo të komenteve nga palë të treta, në lidhje me këtë aplikim, nuk ka rezultuar të ketë pasur të tilla.

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. nuk ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.

- Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”): plotësuar pjesërisht.

- Germa “b” (Të dhëna identifikuese për aplikuesit);

- Germa “c” (Të dhëna për aplikuesin): formati i aplikimit, sipas gjerave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 9, pika 1, të rregullores, nuk është plotësuar sipas kërkesave të rregullores së licencimit, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215/2019, e cila ka hyrë në fuqi më 1.1.2020.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”): plotësuar pjesërisht.

- Germa “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj, në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Shoqëria nuk ka paraqitur vërtetime për gjendjen gjyqësore të personit juridik, në të gjitha selitë e regjistruara të tij.

- Germa “e” (Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve). Ky dokumentacion nuk është paraqitur në formën e kërkuar në nenin 8, pika 3 të rregullores.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”): plotësuar pjesërisht.

Germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.) Shoqëria ka depozituar në ERE një vërtetim bankar, por nuk ka përcaktuar shumën që vendos në dispozicion të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

Germa “d” (Vërtetim për kryerjen e pagesës së regjistrimit për aplikim). Shoqëria nuk ka kryer pagesën për aplikimin për licencim për veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike, por pagesën për aplikim për rinovimin e licencës.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “d”, “f”: plotësuar pjesërisht. Nuk është depozituar në ERE në formatin e kërkuar nga neni 8, pika 3 e rregullores.

Germa “e” (Sistemi IT i krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi). Shoqëria nuk ka depozituar në ERE informacion/dokumentacion, nëse sistemi IT i përcaktuar prej saj është i certifikuar, nëse ka ndonjë kontratë ose marrëveshje për këtë etj.

Germa “g” (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve). Shoqëria nuk ka paraqitur në ERE asnjë dokumentacion mbështetës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI :

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti



**VENDIM**  
**Nr. 62, datë 8.4.2020**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERA HYDRO” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE NGA HEC “STORRI”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Era Hydro’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 15, datë 23.1.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Storri”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 62/3, datë 27.1.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Era Hydro” sh.p.k.

- Me shkresat nr. 292 prot., datë 28.1.2020 dhe nr. 292/1 prot., datë 28.2.2020, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Era Hydro” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 17/1 prot., datë 26.2.2020 dhe së

fundmi me shkresën nr. 292/2 prot., datë 30.3.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar dhe dokumentacionin tjetër plotësues për qëllime të aplikimit për licencim.

- Nga aplikimi u konstatua se kontrata nr. 16 rep. dhe nr. 12/3 kol., datë 5.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Storri’, me kapacitet prodhues 2 mw, në përroin e Holtës dhe të Seltës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”, është lidhur midis mbajtësit të miratimit shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për një afat 49-vjeçar, që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje.

- Hidrocentrali “Storri” do të shfrytëzojë ujërat e përrënjeve të Holtës dhe të Seltës, degë të Lumit Devoll dhe do të ketë dy vepra marrjeje. Parametrat e pasqyruar në “Projektin e zbatimit” për këtë HEC janë të njëjtë me ata të pasqyruar në “Raportin e oponencës teknike” dhe kontratën nr. 16 rep. dhe nr. 12/3 kol., datë 5.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Storri”, me kapacitet prodhues 2 mw, në përroin e Holtës dhe të Seltës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE kontratën e qirasë nr. 7413 prot., datë 26.10.2017, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullor publik”, me palë Bashkinë Gramsh dhe shoqërinë “Era Hydro” sh.p.k. Qëllimi i kontratës është ushtrimi i veprimtarisë për ndërtimin e HEC “Storri”. Afati i kësaj kontrate është 10 vjet me të drejtë rinovimi. Kjo kontratë i fillon efektet ligjore dhe financiare në momentin e pajisjes së subjektit me leje ndërtimi.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE “Miratimin e pikës së lidhjes së HEC ‘Storri’ të shoqërisë ‘Era Hydro’ sh.p.k”. Ky miratim është dhënë për HEC “Storri”. Po ashtu, shoqëria ka depozituar edhe marrëveshjen e lidhjes së re të lidhur midis OSHEE sh.a. dhe “Era Hydro” sh.p.k. në rrejtin elektrik të shpërndarjes. HEC “Storri” do të lidhet në nënstacionin elektrik HEC “Cërrunjë”.

- Shoqëria ka paraqitur lejen e Këshillit të Basenit Ujor Seman, “Për përdorim të Burimit Ujor”, me nr. 00083 seria, nr. 1072/1 prot., datë 30.11.2017 dhe nr. vendimi 24, datë 16.11.2017, lëshuar për shoqërinë “Era Hydro” sh.p.k., për prodhim energjie elektrike, duke përdorur burimin



ujor të Përroit të Holtës, degë e lumit Devoll. Në këtë leje janë pasqyruar koordinatat e zonës ku do të shtrihet veprimtaria, si dhe sasia e prurjeve mesatare për secilën vepër marrjeje. Periudha e vlefshmërisë së kësaj leje është deri në datën 16.11.2022, me të drejtë rinovimi.

- Parametrat e sipërcituar janë të njëjtë me ata të pasqyruar në “Raportin e oponencës teknike” dhe kontratën nr. 16 rep. dhe nr. 12/3 kol., datë 5.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Strori’, me kapacitet prodhues 2 mw, në përroit e Holtës dhe të Seltës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën nr. 940 prot., datë 18.4.2017, të Ministrisë së Mjedisit, VNM-në paraprake, me nr. vendimi 16 dhe nr. identifikimi 258, të lëshuar për “Era Hydro” sh.p.k., për ndërtimin dhe operimin e HEC “Strori”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën e kredisë bankare të përgjithshme nr. 2965 rep., nr. 1285 kol., datë 7.6.2019, me anë të së cilës aplikuesi, ka marrë kredi, me qëllim të vetëm investimin e HEC “Strori”. Shoqëria ka depozituar në ERE, gjithashtu, edhe disa kontrata huaje, që së bashku me kredinë mbulojnë tërësisht vlerën e investimit të parashikuar në planin e biznesit të kontratës së koncesionit.

- Aplikuesi merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 21 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve.

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Era Hydro” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, geramat “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, geramat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, geramat “a”, “b”, “c”, “d”: Plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, geramat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, geramat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;

- Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, geramat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Era Hydro” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Strori”, me kapacitet të instaluar 2000 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të depozitojë në ERE, jo më vonë se 1 muaj para përfundimit të saj, kontratën e qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria, të rinovuar.

3. Shoqëria të depozitojë në ERE, jo më vonë se 1 muaj para përfundimit të saj, lejen “Për përdorimin e burimit ujor”, të rinovuar.

4. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**



**VENDIM**  
**Nr. 63, datë 8.4.2020**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË**  
**“GEGA-G” SHPK, NË VEPRIMTARINË E**  
**PRODHIMIT TË ENERGIJË**  
**ELEKTRIKE NGA HEC “PREVALLI”,**  
**ME KAPACITET TË INSTALUAR 1750 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2 germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 26, datë 10.2.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Prevalli”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 62/8, datë 11.2.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GEGA-G” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 502 prot., datë 17.2.2020, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 502/1 prot., datë 25.2.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 24.8.2001, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara.

- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. është themeluar përpara nënshkrimit të kontratës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe kjo e fundit e ka njohur shoqërinë si mbajtësen e miratimit. Kontrata nr. 2784 rep. dhe nr. 1308/2 kol., datë 14.12.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Prevalli’, me kapacitet prodhues 1.750 mw, në përroin e Zallit të Kostenjës, degë e Zallit të Lunikut, me derdhje në lumin Shkumbin, fshati Prevalli, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, është lidhur për një afat 49-vjeçar, që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje.

- Parametrat e sipërcituar janë të njëjtë me ata të pasqyruar në “Raportin e oponencës teknike” dhe kontratën me MIE-n, nr. 2784 rep. dhe nr. 1308/2 kol., datë 14.12.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Prevalli’, me kapacitet prodhues 1.750 mw, në përroin e Zallit të Kostenjës, degë e Zallit të Lunikut, me derdhje në lumin Shkumbin, fshati Prevalli, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën nr. 8582 prot., datë 4.10.2017, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullësor publik, ndërtim dhe shfrytëzim i HEC ‘Prevalli’, lidhur midis Bashkisë Librazhd dhe shoqërisë ‘GEGA-G’ sh.p.k.”. Kjo kontratë ka në objektin e saj dhënien me qira të fondit pyjor kullësor për përdorim sipërfaqen 0.036 ha; për ndërtimin e bazamentit të shtyllave të tensionit 3.59 km; për shtrirjen e tubacioneve të HEC-it 5.53 km. Qëllimi i kontratës është ushtrimi i veprimtarisë së ndërtimit të HEC “Prevalli”, për prodhim energjie. Kjo kontratë lidhet për një afat 10-vjeçar, duke filluar nga data 4.10.2017 deri në datën 4.10.2027, me të drejtë rinovimi, në zbatim të legjislacionit në fuqi, duke njoftuar njëra-tjetrën 3 muaj para përfundimit të afatit për rinovimin e saj.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, “Miratim ndryshimi, pikë lidhjeje, HEC ‘Prevalli’ për shoqërinë ‘GEGA-G’ sh.p.k.”. Ky miratim është dhënë për kapacitetin e instaluar prej 1750 kw.

- Shoqëria ka paraqitur leje “Për përdorimin të burimit ujor” nr. 61/2 prot., datë 16.10.2017,





miratuar me vendimin nr. 55, datë 10.10.2017, “Për miratimin e lejes së përdorimit të burimit ujor të përroit të Zallit të Kostenjës, degë e lumit Shkumbin, për prodhim hidroenergjie, shoqërisë ‘GEGA-G’ sh.p.k.”. Kjo leje është dhënë për një afat 5 vjeçar dhe është e vlefshme deri në datën 16.12.2022.

- Shoqëria ka depozituar në ERE, VNM-në paraprake nr. 1772 prot., datë 24.7.2017, miratuar me vendimin nr. 30 dhe nr. 532 identifikimi, lëshuar për shoqërinë “GEGA-G” sh.p.k., për të zhvilluar projektin e HEC “Prevalli”.

- Sipas analizës financiare, financimi i veprës parashikohet të bëhet 80% me kredi bankare, me afat shlyerje 10 vjet dhe 20% me burimet e të ardhurave të vetë shoqërisë.

- Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën nr. 8582 prot., datë 4.10.2017, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullësor publik, ndërtim dhe shfrytëzim i HEC ‘Prevalli’”, lidhur midis Bashkisë Librazhd dhe shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k. Kjo kontratë lidhet për një afat 10-vjeçar, duke filluar nga data 4.10.2017 deri në datën 4.10.2027, me të drejtë rinovimi, në zbatim të legjislacionit në fuqi, duke njoftuar njëra-tjetrën 3 muaj para përfundimit të afatit për rinovimin e saj.

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;

- lejen nga institucionet e tjera, neni 9, pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin

ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GEGA-G” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Prevalli”, me kapacitet të instaluar 1750 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të depozitojë në ERE, tre muaj para përfundimit të afatit të saj, kontratën e qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria, të rinovuar.

3. Shoqëria të depozitojë në ERE lejen “Për përdorimin e burimit ujor”, të rinovuar, jo më vonë se data 16.12.2022.

4. Shoqëria, në përfundim të procesit gjyqësor, me objekt shfuqizimin e aktit administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet” nr. 7647/7 prot., datë 29.3.2016, të depozitojë në ERE vendimin përfundimtar të gjykatës.

5. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti



**VENDIM**  
**Nr. 64, datë 8.4.2020**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË**  
**“GEGA-G” SHPK, NË VEPRIMTARINË E**  
**TREGTIMIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe të nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘GEGA-G’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 10.2.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 62/9, datë 11.2.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GEGA-G” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 502 prot., datë 17.2.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 502/1 prot., datë 25.2.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 24.8.2001, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara.

- Aplikimi i shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE vërtetimin nr. 12039 prot., datë 17.12.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, nga i cili rezulton se ndaj shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k. është vendosur masa gjobë, për kundërshtimin e së cilës shoqëria ka paraqitur ankim në gjykatën kompetente.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shoqëria, në përfundim të procesit gjyqësor, me objekt shfuqizimin e aktit administrativ, “Njoftim vlerësimi për detyrimet” nr. 7647/7 prot., datë 29.3.2016, të depozituar në ERE vendimin përfundimtar të gjykatës.

3. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 66, datë 8.4.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 24, DATË 10.2.2020, “MBI PROCEDURËN E SHITJES SË TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREG TË PARREGULLUAR NGA FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË, FTL SHA”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”; të nenit 15, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga drejtoritë teknike, në lidhje me një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 10.2.2020, “Mbi procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga furnizuesi i tregut të lirë FTL sh.a.”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 24, datë 10.2.2020, Bordi i ERE-s vendosi:

- Për një periudhë tranzitore deri në miratimin e rregullave të tregutit të Energjisë elektrike, Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a., për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, të përdorë “Rregullat e përgjithshme të organizimit të

aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a.”, të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.6.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

- Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. të propozojë për miratim në ERE, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, rregullat për tregtimin e energjisë elektrike të mbështetur në parimet e barazisë dhe të transparencës.

- Në datën 10.3.2020, me shkresën nr. 633.1 prot., protokolluar në ERE në datë 30.3.2020, shoqëria FTL sh.a. i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për shtyrjen e afateve të përcaktuara në këtë dispozitë.

- FTL sh.a. bën me dije, se, për shkak të rëndësisë që ky dokument ka, punës së bërë në drejtim të përshtatjes së rregullores së tregutit të energjisë elektrike me rregulloren e shitblerjes së energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103/2016, masave të marra për shkak të përhapjes së epidemisë së COVID-19, kufizimit të aktiviteteve dhe të veprimtarive private e shtetërore në Shqipëri, e ka të pamundur respektimin e afateve të vendosura në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24/2020, për hartimin dhe propozimin për miratim në ERE të rregullave për tregtimin e energjisë elektrike.

- Aktualisht, në vend është shpallur gjendja e epidemisë për shkak të COVID-19. Këshilli i Ministrave ka miratuar disa akte normative mbi masat për parandalimin e virusit COVID-19, duke përcaktuar ndër të tjera edhe kufizim në qarkullimin e njerëzve, por edhe kufizim të disa aktiviteteve gjatë gjendjes së virusit COVID-19.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, është vendosur për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

- Në nenin 53, pika 3 të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet, se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

- Kërkesa e FTL sh.a. është e ligjshme dhe është depozituar në ERE brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.



Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

### VENDOSI

1. Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 24, datë 10.2.2020, “Mbi procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga furnizuesi i tregut të lirë FTL sh.a., bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) FTL sh.a. të propozojë për miratim në ERE, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të fuqisë juridike të akteve ligjore të qeverisë shqiptare për mbrojtjen nga epidemia COVID-19, rregulloren e tregtimit të energjisë elektrike, të mbështetur në parimet e barazisë dhe të transparencës.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

### VENDIM Nr. 69, datë 22.4.2020

#### **MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “GSA” SHPK, PËR ZGJATJE TË AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa “c”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pikat 1 dhe 3, neneve 91 dhe 92, pikat 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; dhe të nenit 24, pika 1, të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në

ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 6, datë 10.1.2020, ka vendosur fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 62/1 prot., datë 14.1.2020, u krye njoftimi në medien e shkruar, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë GSA sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Me shkresat nr. 41 prot., datë 14.1.2020 dhe nr. 41/1, datë 11.2.2020, ERE njoftoi shoqërinë për dokumentacionin e munguar apo nevojën për informacion shtesë të konstatuar në dosjen e aplikimit.

- Dokumentacioni, i cili u konstatua në mungesë apo për plotësim, konsistonte si vijon:

Neni 9, pika 1, “Forma e aplikimit”:

Germa “d” (Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor): plotësuar pjesërisht;

Germa “e” (Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale):

i. Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tri viteve të fundit që paraprijnë paraqitjen e aplikimit: Shoqëria duhet të plotësojë aplikimin e të depozitojë në ERE edhe pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016;

vi. Një plan biznesi i cili përfshin një analizë të kostove dhe të përfitimeve, përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve): Shoqëria nuk ka depozituar një plan biznesi në mbështetje të kësaj kërkesë;

vii. Nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore, ai duhet të informojë ERE-n për këtë synim dhe të japë një garanci të performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej



kësaj shoqërie menaxhimi: Nuk është dhënë informacion mbi këtë kërkesë.

2. Dokumente specifike për llojin e licencës:

ii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet dhe, në veçanti, për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit: Shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimin bankar mbi gjendjen e llogarisë bankare të shoqërisë, pa saktësuar vlerën e përcaktuar nga shoqëria për garantimin e ushtrimit të aktivitetit të furnizimit dhe atë të tregtimit për ushtrimin e të cilit ka aplikuar në ERE.

- Me komunikimin elektronik të datës 3.4.2020, për shkak të kufizimeve dhe situatës së krijuar nga COVID-19, shoqëria ka paraqitur kërkesë për shtyrje të afatit të plotësimit të dokumentacionit deri në normalizimin e gjendjes.

- Shoqëria “GSA” sh.p.k. e ka plotësuar kryesisht dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, si dhe ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për aplikim për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të munguar, në kushtet e situatës së krijuar nga përhapja e epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19 dhe kufizimet e vendosura në të gjithë vendin, me qëllim parandalimin e përhapjes së kësaj sëmundjeje, është e ligjshme.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, janë vendosur kufizime të lirive kushtetuese, të tilla që vështirësojnë lëvizjen e përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara për aplikuesin në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 10.1.2020.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, është vendosur për: Pezullimin e zbatimit të nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e

energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019, si dhe të nenit 9, pika 1, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 4.7.2017.

- Në mbështetje të nenit 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ERE ka kompetencën të shqyrtojë dhe të shprehet në lidhje me kërkesën për shtyrjen e afatit të një procedure nën autoritetin e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike afatin e përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 70, datë 22.4.2020

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “GSA”  
SHPK, PËR ZGJATJE TË AFATIT TË  
PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË  
SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR  
LICENCIM, NË AKTIVITETIN E  
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pikat 1 dhe 3, të neneve 91 dhe 92, pikat 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; dhe të



nenit 24, pika 1, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GSA’ sh.p.k., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 5, datë 10.1.2020, ka vendosur fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 62 prot., datë 14.1.2020, u bë njoftimi në media, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë GSA sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

- Me shkresat nr. 41 prot., datë 14.1.2020 dhe nr. 41/1, datë 11.2.2020, ERE njoftoi shoqërinë për nevojën për informacion shtesë apo dokumentacionin e munguar të konstatuar në dosjen e aplikimit.

- Dokumentacioni, i cili u konstatua në mungesë apo për plotësim, konsiston si vijon:

Neni 9, pika 1: forma e aplikimit;

Germa “d” (Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor);

Akti i regjistrimit në QKR/statuti dhe akti i themelimit të shoqërisë tregtare: shoqëria ka paraqitur në ERE statutin e shoqërisë dhe është konstatuar në mungesë akti i themelimit dhe vërtetimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit;

Germa “e” (Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale):

i. Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tri viteve të fundit që paraprijnë paraqitjen e Aplikimit: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE edhe pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016;

vi. Një plan biznesi, i cili përfshin një analizë të kostove dhe të përfitimeve, përfshirë kostot për

largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve: shoqëria nuk ka paraqitur një plan biznesi;

vii. Nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore, ai duhet të informojë ERE-n për këtë synim dhe të japë një garanci të performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi: shoqëria nuk ka paraqitur informacion.

2. Dokumente specifike për llojin e licencës

Licenca për tregtimin e gazit natyror duhet të përmbajë informacion të përgjithshëm që përfshin sa vijon:

ii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet dhe, në veçanti, për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit: shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimin bankar mbi gjendjen e llogarisë bankare të shoqërisë, pa saktësuar vlerën e përcaktuar nga shoqëria për garantimin e ushtrimit të aktivitetit të tregtimit dhe atë të furnizimit për ushtrimin e të cilit ka aplikuar në ERE.

- Me komunikimin elektronik të datës 3.4.2020, për shkak të kufizimeve dhe situatës së krijuar nga COVID-19, shoqëria ka paraqitur kërkesë për shtyrje të afatit të plotësimit të dokumentacionit deri në normalizimin e gjendjes.

- Shoqëria “GSA” sh.p.k. e ka plotësuar kryesisht dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, si dhe ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për aplikim për licencim në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

- Kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të munguar, në kushtet e situatës së krijuar nga përhapja e epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19 dhe kufizimet e vendosura në të gjithë vendin, me qëllim parandalimin e përhapjes së kësaj sëmundjeje, është e ligjshme.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, janë vendosur kufizime të lirive kushtetuese, të tilla që vështirësojnë lëvizjen e përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara për aplikuesin në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 10.1.2020.



- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, është vendosur: Pezullimi i zbatimit të nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019, si dhe i nenit 9, pika 1, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 97, datë 4.7.2017.

- Në mbështetje të nenit 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ERE ka kompetencën të shqyrtojë dhe të shprehet, në lidhje me kërkesën për shtyrjen e afatit të një procedure nën autoritetin e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të zgjasë me 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike afatin e përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**

#### VENDIM Nr. 71, datë 22.4.2020

#### **MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et “VELESHICA 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5801 kw DHE “VELESHICA 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 8116 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 13917 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neni 11 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.6.2016; dhe të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 739 prot., datë 13.11.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE, me vendimin nr. 189, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr.



32/54, datë 24.11.2019 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta.

- Me shkresat nr. 739/1 prot., datë 3.12.2019, nr. 52 prot., datë 14.1.2020 dhe nr. 52/2 prot., datë 27.1.2020, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe i kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresat me nr. 52/3 prot., datë 10.2.2020 dhe nr. 52/4 prot., datë 13.2.2020, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të konstatuar në mungesë.

- Në konstatim të mangësive të tjera në dokumentacionin e aplikimit të shoqërisë, së fundmi me shkresën nr. 52/5 prot., datë 10.3.2020, ERE iu drejtua serish shoqërisë, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të munguar e që lidhej me vërtetimet e lëshuara nga prokuroria dhe Gjykata e Rrethit të Tiranës, për shoqërinë dhe administratorin e saj.

- Kontrata e Koncesionit nr. 1605 rep. dhe nr. 1037 kol., datë 18.7.2018, “Kontratë koncesionare e formës BOT (ndërtim, operim, transferim) për ndërtimin e hidrocentralit “Veleshicë”, është lidhur midis subjektit për qëllime të veçanta (SPV): “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në cilësinë e Autoritetit Kontraktues. Kjo kontratë ka një afat 35-vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. ka paraqitur edhe kontratën shtesë të koncesionit nr. 7 rep., nr. 3/2 kol., datë 3.1.2019, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim, operim, transferim), për ndërtimin e hidrocentralit “Veleshicë”, të lidhur midis shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. dhe MIE-s.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, “Kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullor publik për shtrirjen e tubacionit dhe të kanalit” për HEC “Veleshica 2”, me nr. 32 prot., datë 3.6.2019, të lidhur midis palëve: Bashkisë Kukës, në cilësinë e qiradhënësit dhe Shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për një afat 1-vjeçar (njëvjeçar), i cili fillon nga momenti i marrjes së lejes përfundimtare të ndërtimit me të drejtë rinovimi të afatit të saj.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, “Kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullor publik”, me nr. 2077 prot., datë 28.3.2019, të lidhur midis palëve: Bashkisë Dibër, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për një afat 10-vjeçar (dhjetëvjeçar), i cili fillon nga data 27.3.2019–27.3.2029, më të drejtë rinovimi 3 muaj përpara përfundimit të afatit të saj.

- Shoqëria ka depozituar në ERE, “Raportin e oponencës teknike” nr. 7441/4 prot., datë 18.10.2018, mbi projektin e zbatimit të HEC-eve “Veleshicë 1 dhe Veleshicë 2” të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., miratuar nga MIE, me shkresën nr. 11068/3., prot., datë 27.12.2018.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. ka përcjellë në ERE marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit me nr. 531, datë 18.1.2019, të lidhur midis saj dhe shoqërisë OST sh.a., për HEC-et “Veleshica”.

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujor”, me nr. 236 prot., datë 1.7.2019, të miratuar nga KBU Drin–Bunë, për shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. dhe “Leje për përdorim të burimit ujor”, me nr. 236/1 prot., datë 1.7.2019, të miratuar nga KBU Drin–Bunë, për shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. Lejet janë lëshuar për secilën nga veprat e marrjes. Periudha e vlefshmërisë së tyre është në përputhje me kontratën e koncesionit.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, “Deklaratën mjedisore”, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 9750 prot., datë 7.12.2018, me nr. 948 identifikimi dhe nr. 57 vendimi, për personin juridik “Kalisi Hydropower” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ndërtim i HEC-eve “Veleshica 1” dhe “Veleshica 2”. Kjo deklaratë mjedisore është lëshuar respektivisht për kapacitetet e instaluara HEC “Veleshica 1” – 5801 kw dhe HEC “Veleshica 2” – 8116 kw, të cilat përkojnë me “Kontratën e koncesionit dhe projektin e zbatimit”. Në këtë deklaratë citohet se zona në të cilën do të zhvillohet projekti, ndodhet jashtë zonave të mbrojtura dhe nuk prek asnjë monument natyre.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., rezulton se subjekti ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose





heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa germa “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germa germa “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, germa germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germa “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, plotësuar pjesërisht. Nuk janë depozituar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore për personin juridik dhe administratorin, të lëshuara nga prokuroria dhe Gjykata e Rrethit të Tiranës.

- Në zbatim të vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 127, datë 10.3.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe të shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, e më tej të vendimit nr. 128, datë 24.3.2020, “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe të shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, të gjitha gjykatat në Shqipëri kanë marrë masa, duke përfshirë pezullimin apo reduktimin e aktiviteteve.

- Në kushtet e aktivitetit të kufizuar të Gjykatave në Republikën e Shqipërisë, sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kërkesës së “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të parashikuar në nenin 9, pika 2, germa “d”, brenda afateve rezultoi i pamundur.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1”, me kapacitet të instaluar 5801 kw, si dhe “Veleshica 2”, me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total 13917 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria, jo më

vonë se 3 (tre) muaj përpara përfundimit të afatit të saj.

3. Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. të depozitojë në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë COVID-19 vërtetimet e lëshuara nga prokuroria dhe Gjykata e Rrethit të Tiranës për shoqërinë dhe administratorin e saj.

4. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 72, datë 22.4.2020

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË  
SHOQËRISË “GREEN ENERGY  
TRADING ALBANIA” SHPK, NR. 286,  
SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERJISË  
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME  
VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S  
NR. 59, DATË 23.4.2015**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”; të nenit 5, pika 1, germa “e”; të neneve 13 dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Për disa ndryshime



të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Për rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 49, datë 24.3.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në medien e shkruar me komunikimin elektronik të datës 24.3.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k.

- Me komunikimin elektronik të datës 24.3.2020, shoqërisë i është dërguar njoftimi i vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., me komunikimin elektronik të datës 10.4.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar. Në datën 25.9.2014 është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

- Shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës (me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 432 prot., datë 13.2.2020, mbërritur në drejtori në datën 20.2.2020). Afati i fundit për të aplikuar për

rinovim licence për këtë shoqëri ishte data 23.2.2020.

Aplikimi i shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungon dokumentacioni i parashikuar në nenin 9, pika 3, germa “d” (Vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Për disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë” është vendosur:

- Pëzullimi i zbatimit të nenit 9, pika 2, germa “d” të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019, si dhe nenit 9, pika 1, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 97, datë 4.7.2017.

- Subjektet e licencuar gjatë kësaj periudhe kanë detyrimin për t’i paraqitur jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë COVID-19 vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.



Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

**VENDIM**  
**Nr. 73, datë 22.4.2020**

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 286, seria T15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 59, datë 23.4.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 24.4.2020.

2. Shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. të depozitojë në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë COVID-19, vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

3. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**

**MBI MIRATIMIN E KONTRATËS TIP,  
PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË  
ELEKTRIKE, NDËRMJET SHOQËRISË  
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS  
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE  
PJESËRISHT NGA SHTETI DHE  
FURNIZUESI I SHËRBIMIT  
UNIVERSAL, PËR FURNIZIMIN E  
KLIENTËVE FUNDORË**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 27.12.2019; të nenit 26, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregulator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga drejtoritë e ERE-s, në lidhje me miratimin e kontratës tip, për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal, për furnizimin e klientëve fundorë,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 8, datë 16.1.2020, vendosi për fillimin e procedurës për miratimin e “Kontratës tip, për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal, për furnizimin e klientëve fundorë”.

- Në vijim, drafti për të cilin ka filluar procedura u është dërguar palëve të interesit për marrjen e



qëndrimin të tyre dhe opinioneve me shkresën e ERE-s nr. 112 prot., datë 21.1.2020.

- Në vijim, me shkresën e ERE-s nr. 108 prot., datë 21.2.2020, u dërgua njoftimi për zhvillimin e një seance dëgjimore, ku u ftuan të marrin pjesë përfaqësues të FSHU sh.a., KESH sh.a., Autoritetit të Konkurrencës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Në datën 5.2.2020, në ERE u organizua seanca dëgjimore në të cilën morën pjesë të gjitha palët e interesit të ftuara për të diskutuar.

- Gjatë kësaj seance dëgjimore, KESH sh.a. shprehu qëndrimin e saj, në lidhje me disa dispozita të draftit për të cilin ka filluar procedura.

- KESH sh.a. kërkoi që në zbatim të ndryshimeve që prodhoi vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 27.12.2019, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244/2016, duke ia lënë në diskrecion të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë së prodhimit, përcaktimin e elementeve të kontratës, si sasi energjie/çmimi i shitjes për nevoja të FSHU sh.a./çmimi i kompensimit mes palëve, të mos parashikohet detyrimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për përcaktimin e këtyre komponentëve, si pjesë e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë së prodhimit.

- Ky konstatim u gjet i drejtë dhe u pranua si i tillë edhe nga palët pjesëmarrëse në seancë.

- KESH sh.a. kërkoi që parashikimi i përfshirë në draftkontratën tip, i cili kërkonte që KESH sh.a., për përcaktimin e sasisë së energjisë që do të ofrojë për sigurimin e shërbimit publik, të bazohet në nivelin historik mesatar vjetor të dhjetë vjetëve të fundit, sipas informacionit të dhënë nga ERE dhe regjimit racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese, të mos jetë pjesë e parashikimeve të kësaj kontrate.

- Sa më sipër, nuk gjeti dakordësinë e përfaqësuesve të FSHU sh.a., të cilët kërkuan që ERE të ketë rol mbikëqyrës mbi termat e referencës së KESH sh.a., për përcaktimin e sasisë së energjisë të parashikuar për përmbushjen e shërbimit publik.

- Në lidhje me sa propozohet nga KESH sh.a., si dhe sa argumentohet nga FSHU sh.a., konstatojmë se vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 27.12.2019, e ka lënë në diskrecionin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë së prodhimit përcaktimin e sasisë së energjisë për sigurimin e shërbimit publik, por kjo nuk

përfundon ERE-n nga roli mbikëqyrës e monitorues, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik nga palët, duke pasur interes parësor mbrojtjen e interesave të klientëve fundorë të energjisë elektrike.

- MIE, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë së prodhimit KESH sh.a., referuar parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 27.12.2019, “Draftkontratës tip, për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit e shërbimit universal FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë” dhe propozimeve të dërguara nga KESH sh.a., me shkresën nr. 308/1 prot., datë 13.2.2020, bën me dije se: “Për përcaktimin e sasisë dhe të çmimit për njësi të energjisë elektrike, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të furnizuesit të shërbimit universal, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, do të bazohet në nivelin historik mesatar vjetor të dhjetë vjetëve të fundit, sipas informacionit të dhënë nga ERE dhe regjimit racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese”.

- KESH sh.a. parashikoi, se kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 2, të draftkontratës tip, se: “Shitësi do t’i dorëzojë Blerësit një faturë, sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të energjisë elektrike të livruar nga Shitësi dhe të konsumuar nga Blerësi për muajin kalendarik paraardhës”, duhet të adresohen në frymën e rregullave të tregut dhe marrëdhëniet e palëve në tregun e energjisë të realizohen bazuar në sasi të nominuara të energjisë elektrike.

- Autoriteti i Konkurrencës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pjesëmarrëse në seancën dëgjimore të organizuar nga ERE, shprehën qëndrimin e tyre se bien dakord me sa propozohet dhe plotësohet nga palët në këtë seancë.

- Në kontratën e përgatitur janë reflektuar edhe ndryshimet e fundit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244/2016 (vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 27.12.2019, ku parashikohet se: “Ndërmjet furnizuesit të shërbimit universal dhe shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nënshkruhet kontrata tip, e miratuar nga Enti Rregullator i



Energjisë, e cila negociohet çdo vit, në lidhje me sasinë e energjisë së siguruar dhe çmimin për njësi, përpara fillimit të çdo viti kalendarik të ushtrimit të aktivitetit”.

- Në kuptim të sa më sipër, janë palët që kanë detyrimin për të negociuar dhe për të nënshkruar me njëra-tjetrën kontratë të rinovuar për çdo vit ushtrimor, në të cilën të reflektohen dispozitat apo ndryshimet e dakordësuara që lidhen ekskluzivisht me elementet çmim dhe sasi.

- Draftkontrata propozohet e strukturuar në 21 nene dhe 2 shtojca, të cilat adresojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve, modalitetet e livrimit të energjisë elektrike dhe të matjes, mënyrën e kushtet e kompensimit për mosperformancë të njëjës nga palët, mënyrat e faturimit dhe të kryerjes së pagesave etj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të miratojë “Kontratën tip, për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal, për furnizimin e klientëve fundorë (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**

Nr. \_\_\_prot., datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_ Nr. \_\_\_prot., datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_

### KONTRATË TIP

PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË  
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE  
TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E  
SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË  
CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT  
OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE  
FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL  
(FSHU) SHA, PËR FURNIZIMIN E  
KLIENTËVE FUNDORË, PËR  
PERIUDHËN KOHORE  
dd.mm.vvvv–dd.mm.vvvv

E lidhur sot, në datën \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_  
ndërmjet:

Shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti i \_\_\_\_\_, e përfaqësuar nga \_\_\_\_\_, administrator i shoqërisë, që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

dhe

Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me objekt aktiviteti në furnizimin me energji elektrike të klientëve fundorë, që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë, \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga \_\_\_\_\_, administratori i shoqërisë \_\_\_\_\_, që më poshtë quhet “Blerësi”,

(“Palët” ose “Pala” në këtë kontratë do të referohen në cilësinë e Shitësit, shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e të cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe në cilësinë e Blerësit, furnizuesit të ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit (FSHU) sh.a.

Baza ligjore: Neni 20, germa “h”, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; vendimi nr. 244, datë 30.3.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe



furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”; vendimi i Bordit të ERE-s, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”; vendimi i ministrit përgjegjës për energjinë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik) Asambleshë e Përgjithshme të Shoqërisë.

Në kushtet kur:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., në aktivitetin e licencuar të furnizuesit është ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit me energji elektrike për kategorinë e klientëve fundorë, që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit me energji elektrike, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit nr. 449, datë 15.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike” dhe të vendimit të Bordit të ERE-s, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”;

- Furnizuesit të Shërbimit Universal i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;

- Sasia e energjisë elektrike, për qëllime të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik, përkundrejt Furnizuesit të Shërbimit Universal, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;

- Ministri përgjegjës për energjinë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti në Asambleshë e Përgjithshme të Shoqërisë), me vendimin -----, datë -----, ka miratuar sasinë dhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike për qëllime të

furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, në kuadër të detyrimit për shërbim publik, si edhe sasinë dhe çmimin, për qëllime të kompensimit financiar për mosperformancë nga ana e shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;

- Sasia e energjisë elektrike dhe çmimi i i miratuar pasqyrohen në kontratën e lidhur nga palët dhe, sipas pikës 2, të nenit 5, të vendimi të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar”;

Palët bien dakord lidhur me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, në kuadër të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik, si më poshtë vijon:

#### Neni 1

### Qëllimi i kontratës

Kjo Kontratë (së bashku me shtojcat e saj) rregullon të gjitha marrëdhënien e shitjes dhe të blerjes së energjisë elektrike ndërmjet Palëve, përfshirë këtu dhe jo vetëm programimin dhe nominimin (livrimin dhe pranimin) e energjisë elektrike për periudhën kohore 1 janar–31 dhjetor.

#### Neni 2

### Sasia e kontraktuar dhe çmimi i shitjes

1. Sasia e programuar (kontraktuar për vitin) e prodhimit të energjisë elektrike, që Shitësi është i detyruar të furnizojë (ose të kompensojë financiarisht) Blerësin, për vitin -----, është ajo e përcaktuar në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. ----- prot., datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_ dhe, sipas këtij vendimi është \_\_\_\_\_ mwh, e cila i furnizohet Blerësit në përputhje me parashikimet e neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate.

2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin \_\_\_\_ është ai i miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. ----- prot., datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_ dhe, sipas këtij vendimi është \_\_\_\_lekë/kwh.



3. Shitësi, në varësi të përmirësimit të kushteve hidrike, të gjithë sasinë e prodhimit të energjisë elektrike mbi atë të parashikuar në pikën 1, por në çdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, është i detyruar t'ia ofrojë (propozojë) fillimisht Blerësit me çmimin e parashikuar në pikën 2.

4. Blerësi, brenda afatit të vendosur nga Shitësi, është i detyruar të konfirmojë mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi, sipas parashikimeve në pikën 2. Në rast se Blerësi, brenda afatit të njoftuar nga Shitësi, nuk konfirmon mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi, sipas pikës 2, propozimi quhet i refuzuar.

### Neni 3 Përkufizimet

1. “Referencat në kohë”, referencat e kohës do të jenë sipas Kohës Qendrore Evropiane (CET).

2. “Përputhja me aktet nënligjore dhe rregullat e tregut”, kjo Kontratë hartohet në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike. Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë, ky parashikim në kontratë konsiderohet i pavlefshëm/pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.

3. “Vlera e kompensimit”, vlera që rezulton për sasinë e energjisë së paplotësuar nga Shitësi me çmimin e përcaktuar, sipas parashikimeve të nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244/2016, të ndryshuar.

4. “Çmim i kontratës”, çmimi i përcaktuar, sipas parashikimeve të nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244/2016, të ndryshuar.

“Fatura e kompensimit”, fatura që do të nënshkruhet nga Shitësi dhe blerësi, në lidhje me sasinë e energjisë të paplotësuar nga ana e Shitësit, në fund të muajit janar të çdo viti për vitin paraardhës.

5. “Dita e punës” do të thotë një ditë (përveç së shtunës dhe së dielës), në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila Palë ka zyrën e saj të regjistruar.

6. “Përgjegjësia për balancimin”, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.

7. “Koha Qendrore Evropiane” ose “CET” do të thotë Koha Qendrore Evropiane dhe do të përfshijë Kohën Dimërore Qendrore Evropiane dhe Kohën Verore Qendrore Evropiane, sipas zbatimit.

8. “Konfirmimi” ka kuptimin e specifikuar në nenet 5 dhe 6.

9. “Kapaciteti i Kontratës”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë kapaciteti i vendosur mes Palëve, i shprehur në mw.

10. “Çmimi i Kontratës”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë, çmimi i vendosur nga Asambleja e Shitësit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244/2016, të ndryshuar.

11. “Sasia e Kontratës”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë sasia e vendosur mes Palëve, sipas nenit 2 të kësaj kontrate, e shprehur në mwh.

12. “Dëmet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 13 (Kufizimi i përgjegjësive financiare).

13. “Pala që nuk përmbush detyrimet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 10 (Pezullimi i livrimit).

14. “Filial”, lidhur me një Palë, do të thotë një njësi e kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ajo Palë, çdo njësi që kontrollon direkt ose indirekt atë Palë ose çdo njësi direkt ose indirekt nën kontrollin e përbashkët të një Pale.

15. “Pika e livrimit”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë pika e livrimit e vendosur mes Palëve.

16. “Programi i livrimit”, lidhur me një kontratë individuale, do të thotë programi i livrimit i vendosur mes Palëve për ditën në avancë, sipas rregullave përkatëse.

17. “Data e pagesës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.2 (Pagesa).

18. “Data e hyrjes në fuqi” ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj Kontrate.

19. “Programi” ka kuptimin e specifikuar në nenin 6, pika 3, dhe 7.2 (Përkufizimi i programit) dhe “i programuar” dhe “programimi” do të interpretohen sipas kësaj.

20. “Taksë” do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksë importi, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjobat dhe shtesat e tyre) që vendosen



nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij) lidhur me çdo pagesë, sipas Kontratës, përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë taksë të ngjashme.

21. Çdo term tjetër i përdorur në këtë kontratë do të lexohet në kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi.

#### Neni 4

### Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

1. Blerësi do t'i paraqesë Shitësit programet mujore/javore/të ditës në avancë me bazë orare/ngarkesës për klientët fundorë, në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe sipas formatit të parashikuar në aneksin e kësaj kontrate.

Blerësi, jo më vonë se 7 ditë kalendrike përpara fillimit të muajit të furnizimit do t'i dërgojë Shitësit të gjitha të dhënat që lidhen me parashikimin e ngarkesës për muajin pasardhës me bazë javore/ditore të ngarkesës.

2. Blerësi, jo më vonë se dita e mërkure e çdo jave do t'i dërgojë Shitësit të dhënat që lidhen me ngarkesën e klientëve fundorë, për sasinë e javës në avancë me bazë ditore/orare.

3. Blerësi, duke marrë në konsideratë programet e dërguara për muajin/javën në avancë nga Shitësi, do t'i dërgojë Shitësit, brenda orës 11:00, programin e ditës në avancë, me bazë orare të ngarkesës.

#### Neni 5

### Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit

1. Shitësi do të furnizojë dhe Blerësi do të pranojë sasinë e energjisë elektrike të konfirmuar nga Shitësi për Blerësin, sipas parashikimeve në pikat 2, 3 dhe 4. Në rast se nuk do të ketë dakordësi midis palëve për sa parashikohet në nenet 4 dhe 5, atëherë për palët do të jetë i detyrueshëm nominimi i pranuar nga platforma e OST-së për nominimet.

2. Shitësi, jo më vonë se 5 ditë kalendrike përpara fillimit të muajit në të cilin do të bëhet furnizimi, do të konfirmojë për Blerësin programet mujore/javore/ditore me bazë orare të prodhimit, si dhe kapacitetin maksimal dhe minimal të furnizimit të detyrueshëm për Blerësin për qëllime të përmbushjes nga Shitësi të detyrimit për shërbim

publik të ofrimit të shërbimeve të balancimit për OST-në.

3. Shitësi, në vijim të konfirmimit, sipas pikës 2, jo më vonë se dita e enjte e çdo jave, do të konfirmojë për Blerësin programet javore/ditore, me bazë orare të prodhimit.

4. Shitësi, duke marrë në konsideratë konfirmimet e dërguara për muajin/javën në avancë, do t'i dërgojë Blerësit, brenda orës 12:00, konfirmimin për programin e furnizimit për qëllime të nominimit në platformën e OST-së, për nominimet për ditën në avancë (me bazë orare të prodhimit, siç kërkohet nga platforma e OST-së për nominimet) dhe do të jetë përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi për ditën në avancë.

#### Neni 6

### Detyrimet kryesore për furnizimin me energji elektrike

1. Përgjegjësia për balancimin e energjisë: Shitësi dhe Blerësi janë subjekte të rregullave në fuqi për balancimin dhe, për rrjedhojë, përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike përkundrejt OST-së (deri sa nuk kanë një marrëveshje që rregullon përgjegjësinë e balancimit me të tretët).

2. Nominimi (livrimi dhe pranimi): Shitësi dhe Blerësi do të nominojnë në platformën e OST-së për nominimet. Bazuar në konfirmimet e bëra paraprakisht, çka përbën konfirmimin për livrimin (Shitësi) dhe pranimin (Blerësi) e energjisë elektrike objekt i kësaj kontrate. Sasia sipas programit të nominuar për ditën në avancë ose *intraday* (në rastet e rishikimit të programit të nominuar) është sasia kontraktuale, për të cilën Blerësi do të paguajë Shitësit me çmimin e përcaktuar në nenin 2 të Kontratës.

3. "Program", sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit dhe të pranimit, që përfshijn programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, agentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës apo me OST-në, sasinë e Kontratës, kapacitetin e Kontratës, pikën e livrimit, programin e furnizimit, periudhën totale të furnizimit dhe çdo kusht tjetër të Kontratës, sipas të gjitha rregullave të zbatueshme dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.





## Neni 7

**Livrimi, matja, transmetimi dhe risku**

1. Rryma/frekuenca/tensionet: Energjia elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në pikën përkatëse të livrimit, sipas standardeve të parashikuara në kodet dhe rregullat në fuqi.

2. Programet e deklaruara: Sasia e energjisë elektrike që do të programohet dhe do të konfirmohet nga Shitësi për Blerësin, do t'i furnizohet këtij të fundit mbi baza vjetore, mujore, javore, ditore dhe orare, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, si dhe kodet e rrjetit. Nominimi fizik/programi i livrimit për ditën e nesërme duhet paraqitur në përputhje me Rregullat e Tregut dhe kodet në fuqi.

3. Dokumentacioni i livrimeve dhe i marrjeve në dorëzim: Bazuar në një kërkesë të arsyeshme, Palët:

- do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë ose do të kontrollojë paraqitjen e programeve, sasive, livrimeve dhe pranimit të energjisë elektrike, për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të kontratës individuale dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike (referuar nominimit në platformën e OST-së për nominimet.

4. Risqet e Shitësit dhe të Blerësit: Shitësi do të marrë përsipër të gjitha risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të programimit, transmetimit dhe livrimit të sasisë së energjisë së parashikuar në Kontratë deri në pikën e livrimit. Blerësi do të marrë përsipër të gjitha risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të programimit, pranimit dhe transmetimit të Sasisë së kontratës në dhe nga pika e livrimit.

5. Pikat e livrimit: Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në kufijtë e sistemit të transmetimit të OST-së, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.

## Neni 8

**Mospërformanca për shkak të forcës madhore**

1. Përkufizimi i “forcës madhore”: Përveçse kur specifikohet ndryshe, “forcë madhore”, për

qëllimet e Kontratës, do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon forcën madhore (Pala Pretenduese), siç përcaktohet në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose të pranimit, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:

a) defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterike të OST-së përkatëse që e pengon Palën pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose

b) pezullimi nga OST-ja përkatëse e livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës pretenduese, lidhur me Programimin sipas Kontratës.

2. Çlirimi nga detyrimet e livrimit dhe pranimit: Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht, për shkak të forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim, sipas një ose më shumë kontratave dhe kjo Palë respekton kërkesat e pikës 8.3 (Njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore), do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo forcë madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet, sipas pikës 8 (Zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim) nuk do t'i merret Palës pretenduese, lidhur me sasi të e palivruara ose të pamarrë.

3. Njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore: Pala pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi mëson për forcën madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e forcës madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala pretenduese do të përdorë të gjitha përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe gjatë vazhdimit të forcës madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

4. Efektet e forcës madhore mbi Palën tjetër: Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit, për shkak të forcës madhore,



Blerësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit, për shkak të forcës madhore, Shitësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të livrimit.

## Neni 9

**Zhdëmtimet/kompensimet**

1. Rasti i mosperformancës nga ana e Shitësit: Në atë shkallë që Shitësi (Pala livruese) nuk i konfirmon Blerësit të gjithë sasinë mujore/javore/ditore të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2, të kontratës, por në çdo rast, jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e forcës madhore, Blerësi (Pala pranuese) ka të drejtën e një kompensimi për sasinë e energjisë elektrike, që rezulton si diferencë ndërmjet sasisë së përcaktuar në pikën 1, të nenit 2 dhe asaj të nominuar, sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5. Në rast se kjo sasi nuk do të plotësohet, atëherë do të kompensohet, sipas nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, të ndryshuar.

2. Rasti i mosrespektimit nga ana e Blerësit: Në atë shkallë që programet e nominuara nga Blerësi dhe nga Shitësi, për ditën në avancë (ose *intraday*), sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5, rezultojnë më të vogla se sasia konfirmuara për muajin në avancë, atëherë Shitësi, për efekt të llogaritjes së sasisë vjetore të energjisë elektrike, në kuadër të detyrimit për shërbim publik, konsiderohet se ka përmbushur detyrimin për periudhën në fjalë në sasinë e konfirmuar për muajin në avancë.

3. Në atë shkallë që programet e dërguara nga Blerësi dhe të konfirmuara nga Shitësi, në lidhje me sasinë e energjisë elektrike për muajin përkatës, në përputhje me parashikimet e neneve 4 dhe 5, rezultojnë më të mëdha se sasia e parashikuar në pikën 1, të nenit 2, dhe kjo energji ka shkuar për furnizimin e klientëve fundorë, atëherë Shitësi konsiderohet se ka përmbushur në masën e energjisë elektrike të nominuar, për ditën në avancë (ose *intraday*).

4. Shuma e pagueshme: Shumat e pagueshme, sipas nenit 9, do të faturohen dhe do të paguhen sipas nenit 14 (Faturimi dhe pagesa).

## Neni 10

**Pezullimi i livrimit**

Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera mundshme, nëse “Pala që nuk përmbush detyrimet” nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur, sipas Kontratës ose sipas kushteve të garancive, nëse do aplikohen nuk arrin ta sigurojë apo ta zëvendësojë vlerën e kërkuar sipas Kontratës, Pala që përmbush detyrimet do të autorizohet, jo më parë se 3 (tre) ditë pune pas dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike dhe të çlirohet (jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit, sipas të gjitha kontratave specifike deri kur Pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e tjera), të të gjitha shumave të papaguara që i detyrohen palës që përmbush detyrimet.

Pezullimi i livrimeve apo i çlirimeve të detyrimeve të tjera të livrimit nga Palët mund të bëhet vetëm me miratimin e ERE-s.

## Neni 11

**Kohëzgjatja**

1. Kontrata është e vlefshme për periudhën 1 janar–31 dhjetor.

## Neni 12

**Kufizimi i përgjegjesisë financiare**

1. Përrjashtësi i përgjegjesisë financiare: Subjekt i pikave 13.2 dhe 13.3 dhe përveç kur lidhet me shumën e pagueshme sipas nenit 9 (Zhdëmtimet), një Palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj Palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm (Dëmet), (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare, për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një Kontrate specifike), që pëson Pala tjetër, sipas Marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mospagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një Pale ose i punonjësve, i zyrtarëve, përdorur nga kjo Palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas Kontratës.



2. Dëmi pasues dhe kufizimi i përgjegjësisë financiare: Subjekt i pikës 13.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas Kontratës ose lidhur me të:

a) nuk përfshin përgjegjësinë financiare për dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, të klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe

b) kufizohet me një shumë të barabartë me shumat e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një Palë, sipas çdo Kontrate specifike përkatëse, me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 9 (Zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim).

3. Mospagesa e qëllimshme, mashtrimi dhe të drejtat themelore: Asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose për të kufizuar përgjegjësinë ligjore të Palës, për:

a) mospagesën e qëllimshme;

b) mashtrimin; ose

c) çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një Pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një Pale.

4. Detyra për lehtësimin e humbjeve: Për shmangien e dyshimit dhe subjekt i legjislacionit në fuqi, çdo Palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë dëmet dhe premton që do të përdorë përpjekje komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo dëmi që mund të pësojë, sipas Kontratës ose lidhur me të.

#### Neni 13

### Faturimi dhe pagesa

1. Fatura: Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë, sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të Energjisë Elektrike të livruar nga Shitësi te Blerësi, sipas nominimeve ditore të konfirmuara për muajin paraardhës. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës).

2. Pagesa: Blerësi do t'i kryejë pagesën Shitësit kundrejt vlerës së faturës mujore të nënshkruar nga Palët. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të faturës nga Shitësi: data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.

3. Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës, brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës do të jetë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Faturimi dhe pagesa e sasive të programuara Kontraktuale: Faturimi dhe pagesa do të bazohen në sasitë e programuara/nominuara të kontratës, në përputhje me të gjitha rregullat në fuqi për dërgimin e programeve për muajin përkatës. Kur dhe nëse të dhënat faktike bëhen të disponueshme dhe konfirmojnë se sasitë faktike të energjisë elektrike të livruara dhe të marra nga palët ndryshojnë nga ato të përcaktuara në programet e dërguara, faturimi dhe pagesa do të rregullohen për të pasqyruar çdo devijim midis sasive të kontraktuara dhe livrimeve faktike të energjisë elektrike.

5. Shumat e diskutueshme: Për çdo pretendim që lidhet me saktësinë e faturës, do të jepet një shpjegim me shkrim nga Shitësi ose Blerësit dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda muajit të faturuar, në të kundërt do të paguhet shuma e faturuar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat (shtesat apo pakësimet) nga korrektimet do të reflektohen në muajt pasardhës.

#### Neni 14

### Taksat dhe tatimet

Çdo çështje që lidhet me taksat dhe tatimet rregullohet në përputhje me legjislacionin respektiv për taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 15

### Transferimi

1. Ndalimi: Asnjëra Palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, një pale të tretë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme. Çdo transferim i të drejtave dhe i detyrimeve bëhet efektiv pas miratimit nga ERE.

2. Transferimi te filialet: Çdo Palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, një filiali me aftësi paguese të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër



dhe miratimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

Neni 16

### Përfaqësimet dhe garancitë

1. Për të adresuar riskun e çdo Pale, për sa i përket mundësisë për përmbushjen e detyrimeve të palës tjetër dhe për të siguruar përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rezultojnë nga kjo Kontratë apo kontrata specifike, Palët mund të dakordësojnë, më parë apo në çdo kohë pas hyrjes

në fuqi, ose në kohën pas nënshkrimit të kontratave specifike, ekzistencën e mbështetjes me garanci kredie dhe garantuese, sipas kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të dakordësuara prej tyre.

Neni 17

### Personat e kontaktit

Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me *email* ose faks:

Për Blerësin	Për Shitësin
<b>Administratorët e Kontratës</b>	
Z./znoj. _____ Funksioni _____ Tel.: _____ Email: _____	Z./znoj. _____ _____ Tel.: _____ Email: _____
<b>Operatorët/skeduluesit</b>	
Z./Znoj. _____ Funksioni _____ Tel.: _____ Email: _____	Z./znoj. _____ _____ Tel.: _____ Email: _____

Neni 18

### Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi në Republikës së Shqipërisë.

2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve: Nëse palët nuk arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet për zgjidhje ERE-s. Sa më sipër, nuk përjashton të drejtën e palëve për të adresuar nëpërmjet gjykatës zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje të krijuar në interpretim apo kuptim të kësaj kontrate.

Neni 19

### Të ndryshme

1. Regjistrimi i bisedave telefonike: Çdo Palë lejohet të regjistrojë bisedat telefonike të mbajtura

lidhur me Kontratën dhe t'i përdorë si provë. Çdo Palë pranon se ka marrë të gjitha pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe të punonjësve të vet për këto regjistrime dhe këto ia bashkëngjit kësaj kontrate.

2. Njoftimet dhe komunikimet: Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palët, të gjitha njoftimet, deklaratat e dërguara nga një Palë tjetër duhet të jenë me shkrim (postë të shpejtë ose korrier). Çdo Palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:

a) nëse shpërndahen dorazi ditën e punës ose ditën e parë të punës pas datës së fundit të livrimit;

b) nëse dërgohen me postë, ditën e 2-të të punës pas datës së postimit ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në ditën e 5-të të punës pas datës së postimit;

c) nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që



konfirmon marrjen, ditën e transmetimit, nëse është transmetuar para orës 17:00 (me orën e marrësit) në ditën e punës ose në orën 09:00 (me orën e marrësit) në ditën e parë të punës pas transmetimit.

3. Amendimet: Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët, dhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.

4. Pavlefshmëria e pjesshme: Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Kontrate, nuk do të preken ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Në rast se legjislacioni në fuqi sjell ndryshime të dispozitave të kësaj kontrate, deri në miratimin nga ERE të këtyre ndryshimeve, legjislacioni i zbatueshëm do të prevalojë në kuptimin dhe interpretimin e këtyre dispozitave.

Neni 20

#### **Miratimi i ERE-s, efektet dhe zgjidhja e parakohshme**

1. Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën 1 janar–31 dhjetor.

2. Palët kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n lidhur me nënshkrimin e kësaj kontrate.

3. Kjo kontratë tip mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ERE-s.

Neni 21

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barasvlershme, 2 (dy) për secilën palë.

ADMINISTRATOR

ADMINISTRATOR

Shtojca 1: Programet e livrimit, sipas neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate

Shtojca 2: Sipas nenit 19 të kësaj kontrate, “Pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe të punonjësve të Palëve për regjistrimet telefonike”

## VENDIM

Nr. 74, datë 22.4.2020

### **MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË 25.11.2019, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MP-HEC” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇË”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2270 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rishikimin e vendimit nr. 187, datë 25.11.2019, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘MP-HEC’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Niçë’ me kapacitet të instaluar 2270 kw””,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 25.11.2019, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 kw, për një afat 24 vjet e 2 muaj, me kusht që:

a) Shoqëria “MP HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE, pas nënshkrimit, kontratën shtesë të koncesionit, në vijim të miratimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC “Niçë”;

b) Shoqëria “MP HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE “Lejen e shfrytëzimit të ujit”, të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga MIE, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) Shoqëria “MP HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE “Lejen mjedisore”, të rinovuar, në përputhje



me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga MIE, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Shoqëria “MP HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE informacion mbi statusin e çdo dokumenti/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto dokumente/leje.

3. Shoqëria “MP HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar para fillimit të operimit të veprës.

4. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij

- Shoqëria “MP HEC” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrjen me 6 muaj të afatit të dorëzimit të miratimit të prurjes së re të ujit, në përputhje me “Projektin e zbatimit të përmirësuar”, të miratuar me shkresën e MIE-s, nr. 11965/1, datë 13.12.2018, në konstatim të situatës së krijuar, për shkak të kufizimeve të vendosura për të parandaluar përhapjen e epidemisë COVID-19.

- Me shkresën e datës 14.3.2020, protokolluar në ERE me nr. 289/10 prot., datë 30.3.2020, shoqëria ka përcjellë në ERE shkresën nr. 922 prot., datë 24.2.2020, “Për VNM-në paraprake” të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, drejtuar shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., për kapacitetin 2270 kw, në bazë të miratimit të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC “Niçë”, nga MIE, me nr. 11965 prot., datë 13.12.2018.

- Shoqëria ka plotësuar në këtë mënyrë kushtin e vendosur në germën “c”, të pikës 1, të vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019.

- Shoqëria “MP HEC” sh.p.k. ka përcjellë në ERE shkresën e adresuar për MIE-n, nr. 523 prot., datë 24.2.2020, me anë të së cilës bën me dije se për sa i përket kushtit të vendosur në pikën 1, germa “a”, të vendimit të licencimit nr. 187, datë 25.11.2019, ka përsëritur shkresën adresuar për Autoritetin Kontraktor, në lidhje me nënshkrimin e kontratës shtesë, duke i kërkuar ministrisë që të shprehet në rast se nuk është e nevojshme që të formalizohet me shtesë kontrate koncesioni. “Projekti i zbatimit i përmirësuar”, i cili është miratuar nga MIE me shkresën nr. 11965/1 prot., datë 13.12.2018: shoqëria ka deklaruar se është në pritje të kthimit të përgjigjes nga MIE.

- Për sa i përket kushtit të vendosur në germën “b”, të pikës 1, të vendimit nr. 187, datë

25.11.2020, shoqëria vetëm në datën 30.3.2020, me shkresën me nr. 289/10 prot., ka paraqitur në ERE shkresën nr. 1272/1 prot., të datës 3.11.2019, të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore drejtuar shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., për dizeni MIE-s, ku ndër të tjera përcaktohet, se, për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në projektin e zbatimit të miratuar nga AKBN-ja, përpara nisjes së procedurave për ndryshimin e kontratës koncesionare me MIE-n, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor duhet të aplikojë pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) për marrjen e autorizimit për miratimin në parim për përdorimin e burimit ujor nga KKU-ja.

- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) saktëson se këto ndryshime duhet të reflektohen në kontratën koncesionare të lidhur mes MIE-s dhe shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k. dhe, se shoqëria duhet të aplikojë për leje pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin–Seman, pas plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm.

- Shoqëria ka përcjellë kërkesën me të cilën i është drejtuar Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin–Seman, me nr. 342 prot., datë 19.2.2020, “Aplikim për miratim përfundimtar të prurjes së ujit, të projektit të përmirësuar të HEC “Niçë” dhe bën me dije se është në pritje të përfundimit të procedurës.

- Rezulton se shoqëria “MP HEC” sh.p.k. ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, germa “c”, të vendimit nr. 187, datë 25.11.2019, të Bordit të ERE-s.

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, të kontratës koncesionare të formës BOT, me nr. 311 rep. dhe nr. 45 kol., datë 2.2.2009, “Për ndërtimin e HEC “Niçë”, të lidhur ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërisë “DEVY” sh.p.k. me “ZYFI” sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit dhe autoritetit kontraktues, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në zbatim të VKM-së nr. 217, datë 21.2.2008, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC “Niçë”.

- Kërkesa e shoqërisë për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, në konstatim të pamundësisë objektive për të përmbushur detyrime të përcaktuara në vendimmarrjen e ERE-s, për shkak të shpalljes së



gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vend, është e drejtë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, si më poshtë:

a) Pika 1, germa “b” ndryshon: “Shoqëria “MP HEC” sh.p.k. të depozitohet në ERE, “Lejen e shfrytëzimit të ujit”, të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, para fillimit të operimit të veprës.”.

b) Pika 1, germa “c” shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 75, datë 22.4.2020

### **MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SPAHIU GJANÇ” SHPK, PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-s, PËR LËNIEN PENG TË KUOTAVE**

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të pikës 5.2 të “Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, të pikës 6.2 të “Licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës

22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., për dhënie autorizimit nga ana e ERE-s, për lënie peng të kuotave,

konstatoi se:

- Shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 11, seria PV03K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 20, datë 19.12.2003, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gjanç”, me kapacitet të instaluar 3.7 mw, për një afat 30-vjeçar, si dhe të licencës nr. 224, seria T14P, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014, të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 20-vjeçar.

- Shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me shkresën protokolluar në ERE me numrin 87/1 prot., datë 23.1.2020, shkresën nr. 87/3 prot., datë 17.2.2020, dhe me shkresën e dërguar me komunikim elektronik në datën 9.4.2020, protokolluar në ERE me nr. 86/5 prot., datë 14.4.2020, ka depozituar dokumentacion dhe informacion shtesë, në lidhje me kërkesën për marrjen e autorizimit të ERE-s, për vendosjen e pengut mbi kuotat e shoqërisë.

- Kërkesa e shoqërisë për pajisje me autorizim nga ana e ERE-s vjen në zbatim të pikës 6.2 të licencës, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe të pikës 5.2, të “Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE vendimin nr. 5194 rep. dhe nr. 758 kol., datë 20.12.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., si dhe shkresat drejtuar MIE-s (Ministria e Industrisë dhe Energjisë) dhe MBZHR-së (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), në lidhje me njoftimin për aplikimin dhe marrjen e një kredi bankare.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE kontratën e kredisë bankare, nr. 3699 rep., nr. 1304 kol., datë 20.12.2019, lidhur ndërmjet “Intesa San Paolo Bank” sh.a. (Banka) dhe shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k. (Kredimarrësi), ku parashikohet detyrimi i shoqërisë për të paraqitur jo më vonë se muaji mars 2020 miratimin/autorizimin e nevojshëm me shkrim lëshuar nga ERE (Enti Rregullator i Energjisë) lidhur me pengjet/barrët siguroese të radhës së parë që do të vendosen mbi kuotat e shoqërisë koncesionare, me qëllim garantimin e të



gjitha detyrimeve të rrjedhura për kredimarrësin prej kontratës së kredisë.

- Me shkresën nr. 87/2 prot., datë 11.2.2020, ERE i ka kërkuar shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën për cedim kuote nr. 2726 rep., 492 kol., datë 8.8.2019; kontratën për cedim kuote nr. 3452 rep., 576 kol., datë 20.9.2019; si dhe kontratën për shitblerje kuotash me nr. 3453 rep., 575 kol., datë 20.9.2019, që listohen në kontratën e kredisë nr. 3699 rep., nr. 1304 kol., datë 20.12.2019, me qëllim qartësimin e të gjitha lëvizjeve dhe veprimeve që janë kryer për transferimin e kuotave dhe për të kuptuar sa më qartë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga këto kontrata.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE kontratën për cedim kuote nr. 2726 rep., nr. 492 kol., datë 8.8.2019; kontratën për cedim kuote nr. 3452 rep., 576 kol., datë 20.9.2019; si dhe kontratën për shitblerje kuotash me nr. 3453 rep., 575 kol., datë 20.9.2019.

- ERE i dërgoi shoqërisë njoftimin nr. 538 prot., datë 27.2.2020, për zhvillimin e një seance dëgjimore, me qëllim marrjen e shpjegimeve të nevojshme, në lidhje me hapat proceduralë të ndjekur nga shoqëria për marrjen e kësaj kredie.

- Për shkak të marrjes së masave shtrënguese nga qeveria shqiptare, me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë COVID-19, rezultoi e pamundur të zhvillohej një seancë dëgjimore me aplikuesin.

- Me komunikimin elektronik të datës 9.4.2020, protokolluar në ERE me nr. 86/5 prot., datë 14.4.2020, shoqëria ka dhënë shpjegime të zgjeruara në lidhje me sa kërkohej nga ERE.

- Aplikuesi ka bërë me dije, se kredia bankare, për të cilën kërkohet nga ERE autorizimi për lënie peng të kuotave të shoqërisë, ka si objekt ripagimin e ortakut, që do të thotë rikthimin e detyrimit të financimit që shoqëria koncesionare “Spahiu Gjanç” sh.p.k. ka përkundrejt ortakut të vetëm, shoqëria “Hydro Invest” sh.p.k.

- Me lënie peng të kuotave, shoqëria ekspozohet ndaj një ndryshimi potencial të aksionarit, në rrethanat e pamundësisë likuiduese për të shlyer kredinë e në këto kushte ndodhet në rrethanat e parashikuara në pikat 6.2 të licencës, “Për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike” dhe të pikës 5.2, të “Licencës së

veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, objekt i shqyrtimit e autorizimit nga ERE.

- Shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k. ka kryer pagesat e rregullimit dhe nuk është debitore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Dhënie e autorizimit nga ana e ERE-s, për lënie peng në favor të Bankës Intesa San Paolo Bank sh.a. të kuotave të shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., që zotërohen 100% nga shoqëria “Hydro Invest” sh.p.k.

2. Shoqëria të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e pengut mbi kuotat.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 76, datë 22.4.2020

### **MBI KËRKESËN E ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË SË OST SHA, PËR SHTYRJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË “RAPORTIT VJETOR TË PAJTUESHMËRISË” TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, kreut VI, germa “C”, pika 1, të “Programit të pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 103,





datë 30.4.2018, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e zyrtarit të pajtueshmërisë së OST sh.a., për shtyrjen e afatit të dorëzimit të ‘Raportit vjetor të pajtueshmërisë’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 103, datë 30.4.2018, ka vendosur të miratojë “Programin e pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike”.

- Në kreun VI, germa “C”, pika 1, të këtij Programi, përcaktohet si vijon: “Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], zyrtari i pajtueshmërisë duhet të përgatisë dhe të dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST-së me këtë Program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-s”.

- Me komunikimin elektronik të datës 9.4.2020, zyrtari i pajtueshmërisë së OST sh.a. ka bërë me dije, se, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore me VKM-në nr. 243, datë 24.3.2020, ka qenë i pamundur përfundimi i raportit vjetor, brenda afatit të caktuar.

- Duke marrë në konsideratë gjendjen e krijuar, për shkak të COVID-19 dhe kufizimet që janë vendosur, me qëllim parandalimin e përhapjes së këtij infeksioni, kërkesa e zyrtarit të pajtueshmërisë për të shtyrë afatin e dërgimit të raportit vjetor deri jo më vonë se 1 muaj pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, është e drejtë dhe në harmoni me vendimmarrjet e ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, si dhe nr. 67, datë 8.4.2020, mbi masat e përkohshme për trajtimin e çështjeve në kompetencë të ERE-s, pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në kreun VI, germa “C”, pika 1, të “Programit të pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 30.4.2018, deri jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë Zyrtarin e Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, si dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

## VENDIM

Nr. 77, datë 22.4.2020

### **MBI KËRKESËN E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË “ALBGAZ” SHA, PËR SHTYRJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË “RAPORTIT VJETOR TË PËRPUTHSHMËRISË” TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, kreut VI, germa “C”, pika 73, të “Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e zyrtarit të përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a., për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të përputhshmërisë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017, “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të



transmetimit për gazin natyror” ka vendosur të miratojë “Programin e përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror” (RCP).

- Në kreun VI, germa “C”, pika 73, të këtij programi, përcaktohet si vijon: 1. Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], zyrtari i përputhshmërisë duhet të përgatisë dhe të dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST-së me këtë program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-s.

- Me komunikimin elektronik të datës 8.4.2020, zyrtari i përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a., ka bërë me dije se në kushtet kur, qeveria shqiptare, me anë të vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, ka vendosur shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe pas masave të marra për kufizimin e lëvizjes, ka rezultuar i pamundur verifikimi i të dhënave, rishikimi i korrespondencave, si dhe përditësimi i informacionit për përfundimin e “Raportit vjetor të përputhshmërisë”, për vitin 2019, për “Albgaz” sh.a.

- Duke marrë në konsideratë gjendjen e krijuar, për shkak të COVID-19 dhe kufizimet që janë vendosur, me qëllim parandalimin e përhapjes së këtij infeksioni, kërkesa e zyrtarit të përputhshmërisë për të shtyrë afatin e dërgimit të raportit vjetor deri jo më vonë se 1 muaj pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga

COVID-19, është e drejtë dhe në harmoni me vendimmarrjet e ERE-s nr. 51 datë 26.3.2020, si dhe nr. 67, datë 8.4.2020, mbi masat e përkohshme për trajtimin e çështjeve në kompetencë të ERE-s, pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në kreun VI, germa “C”, pika 73, të “Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017, deri jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë Zyrtarin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, si dhe OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 532 lekë